



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 294 Akti

Nr. 340 Vendimi
Tiranë, më 1.2.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 25.1.2021, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Klodiana Gjyzari**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.3.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Brunilda Bektoshi dhe Alma Faskaj. Komisionere Alma Faskaj dha dorëheqjen për shkak të ekzistencës së konfliktit të interesit, në datën 29.3.2019, të cilën Komisioni e pranoi me vendimin e datës 9.4.2019. Me vendimin nr. 18, datë 9.3.2020, të Komisionit, për këtë çështje caktohet si anëtare trupe komisionere Valbona Sanxhaktari. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia.

4. Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues, komisionere Valbona Sanxhaktari, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua shkresa me nr. **** prot., datë 4.5.2018, e ILDKPKI-së, me anë të së cilës u dërgua një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. **** prot., datë 7.12.2020 (deklasifikuar pjesërisht në raport me vendimin nr. ****, datë 9.12.2020, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari.*

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. **** prot., datë 11.5.2020, për subjektin e rivlerësimit, ardhur në Komision me shkresën nr. **** prot., datë 16.6.2020.

11. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: atë të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të figurës në datën 22.5.2019, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari; (ii) njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 23.12.2020 mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti u njoh me aktet e dosjes në datën 24.12.2020 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më 11.1.2021.

14. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 19.1.2021, vendosi të ftojë znj. Klodiana Gjyzari në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 19.1.2021.

16. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqipërisë”, në datën 25.1.2021, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

17. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Znj. Klodiana Gjyzari ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017^[1] të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

^[1] “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) “Deklarata e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/I Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së saj dhe personave të lidhur me të, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Znj. Klodiana Gjyzari është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me nr. indeksi **** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, si vijon:

- deklaraten para fillimit të detyrës të vitit 2003;
- deklaraten periodike/vjetore për vitet 2004 - 2017;
- deklaraten e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, për efekt të ligjit nr. 84/2016.

A/II Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;

- c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”, me nr. indeksi ****, datë 23.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2003 – 2017, në raport me të dhënat e “Deklaratës së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri:

1. Apartament banimi me sip. 102,22 m², në lagjen “***”, Vlorë**

Hetimi i kryer nga Komisioni

1.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë apartament banimi, me sip. 102,22 m², lagjja “*****”, pallati ****, Vlorë.

Burimi i krijimit: blerë gjatë martesës me paratë e ish-bashkëshortit. Vlera: 3.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

1.2 Rezultoi se për këtë pasuri subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti kanë lidhur pranë noterit kontratën e shitblerjes me nr. ****, datë 8.2.2006, me palë shitëse shoqërinë “*****” sh.p.k., me ortak të vetëm shtetasin L.Gj. Në kontratë është përcaktuar vlera e blerjes së pasurisë prej 3.000.000 lekësh, e cila është deklaruar si e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

1.3 Pala shitëse, shoqëria “*****” sh.p.k., në momentin e shitjes së pasurisë zotëronte certifikatë për vërtetimin e pronësisë për pasurinë apartament me sip. 102,22 m², me nr. pasurie ****, në lagjen “*****”, lëshuar në emër të saj në datën 18.2.2005.

1.4 Pas blerjes së pasurisë subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti janë pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie (në bashkëpronësi) për apartamentin me sip. 102,22 m², me nr. pasurie ****, z. k. ****, vol. ****, f. ****, me adresë: lagjja “*****”, Vlorë, lëshuar në datën 6.3.2006.

1.5 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me konfirmimin e burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, paraqiti në Komision deklaratën noteriale nr. ****, datë 26.10.2016, të hartuar pranë zyrës së noterisë Tiranë (noter G.K.D). Sipas kësaj deklarate shtetasit S.Gj, A.Gj (prindërit e ish-bashkëshortit të subjektit) dhe ish-bashkëshorti i subjektit, deklarojnë se kanë qenë me ekonomi të përbashkët deri në vitin 2003. Gjatë kësaj periudhe ata kanë krijuar disa pasuri. Në vitin 2001 familja e ish-bashkëshortit të subjektit është shkëputur nga ekonomia e përbashkët dhe është zhvendosur të jetojë në Vlorë. Për këtë shkak prindërit deklarojnë se i kanë dhënë ish-bashkëshortit të subjektit si kontribut në ekonomi shumën prej 3.500.000 lekësh. Kjo shumë

përbëhet nga shuma 1.650.000 lekë, e cila rrjedh nga shitja e pasurisë apartament banimi e ndodhur në Berat (sipas kontratës nr. ****, datë 17.4.2001) dhe diferenca nga të ardhurat e nxjerra nga aktiviteti i përbashkët tregtar.

1.6 Gjatë fazës së hetimit subjekti ka deklaruar se ish-bashkëshorti ka kontribuar ndër vite së bashku me familjen e tij të origjinës deri në dhjetor të vitit 2001, ku ka përfituar si kontribut shumë prej 3.500.000 lekësh.

1.6.1 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 subjekti ka deklaruar pasurinë *shtëpi banimi me sip. 102,22 m², në lagjen “****”, blerë në shumën 3.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %*. Por në këtë deklaratë subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme.

1.7 Pas kërkesës së bërë nga Komisioni, ZVRPP-ja Vlorë¹ ka konfirmuar se në emër të subjektit dhe ish-bashkëshortit rezultoi e regjistruar pasuria e llojit “apartament”, me nr. pasurie ****, z. k. ****, vol. ****, f. ****, në Vlorë. Kjo pasuri është regjistruar bazuar në kontratën e shitblerjes datë 8.2.2006, në vlerën 3.000.000 lekë.

1.8 Gjatë hetimit të kryer për këtë pasuri u konstatuan disa problematika, për të cilat Komisioni i kërkoi sqarime subjektit të rivlerësimit², si vijon:

1.8.1 Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë përse zotëron 50 % të kësaj pasurie të paluajtshme, kur nga ana tjetër ka deklaruar se ajo është krijuar vetëm nga të ardhurat e ish-bashkëshortit të saj dhe familjes së tij. Gjithashtu, ju kërkua të sqarojë pse nuk është deklaruar prej saj kjo pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005.

Në përgjigje të pyetësorit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Në përgjigjen time i jam referuar akteve shkresore, si certifikata e pronësisë së këtij apartamenti, sipas të cilave është përcaktuar bashkëpronësia në pjesë ideale. Kjo pasuri nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2005, për shkak se kontrata e blerjes së saj është nënshkruar në vitin 2006. Deri në nënshkrimin e kontratës së shitblerjes, ndërmjet blerësve dhe shitësve nuk ka qenë nënshkruar kontratë tjetër me shkrim, as porosie. Për pasojë kam menduar që nuk mund të deklaroja një pasuri të paluajtshme të cilën e kisha në posedim, por nuk më kishte kaluar juridikisht në pronësi”*.

1.8.2 Në përgjigje të rezultateve të hetimit³, subjekti ka deklaruar se shumë prej 3.000.000 lekësh ia ka dhënë shitësit që në shkurt të vitit 2005.

Lidhur me këtë deklaram, Komisioni konstatoi se subjekti nuk arriti të provonte pagesën e kryer në shkurt të vitit 2005, si dhe nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratat periodike vjetore të viteve 2004 - 2005 dhe as pagimin e detyrimeve financiare prej 3.000.000 lekësh të kryer në vitin 2005 (detyrim ky që rrjedh nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003).

1.8.3 Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë pse kjo pasuri është regjistruar edhe në emrin e saj që nga momenti i blerjes, kur në deklaratën *Vetting* është deklaruar si pasuri e përfituar vetëm me të ardhurat e bashkëshortit. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të deklarojë pse përdoret ende kjo pasuri e krijuar nga të ardhurat e ish-bashkëshortit dhe nëse kanë filluar procedurat për pjesëtimin e saj pas divorcit.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të saj, ka deklaruar se: *“Kjo pasuri është regjistruar edhe në emrin tim për shkak se kontrata noteriale përcaktonte bashkëpronësinë në pjesë edhe timen, edhe të ish-bashkëshortit tim, me cilësinë e bashkëshortëve në kohën e lidhjes së kontratës. Kjo pasuri është përdorur prej meje edhe pas zgjidhjes së martesës, deri në shitjen e kësaj pasurie,*

¹ Shihni përgjigjen e ZVRPP-së Vlorë në dosjen e Komisionit.

² Shihni pyetjet e Komisionit dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të dërguara nga subjekti i rivlerësimit.

³ Shihni përgjigjen e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

duke qenë se kam pasur fëmijët e mitur në ngarkim dhe kam pasur më shumë nevojë për banesë, e drejtë kjo e parashikuar nga ligji.

*Bashkësia ligjore, pjesë e së cilës ka qenë edhe apartamenti, nuk i është nënshtruar likuidimit nëpërmjet procesit gjyqësor, por nëpërmjet likuidimit vullnetar. Kjo pasuri është shitur me kontratën e shitblerjes nr. ****, datë 29.7.2019, në vlerën 5.490.000 lekë. Me deklaratën noteriale nr. ****, datë 3.10.2019, është kryer “likuidimi i regjimit martesor”, mbi bazën e të cilit ish-bashkëshorti ka marrë vlerën 3.000.000 lekë si pasurie vetjake dhe diferenca prej 2.490.000 lekësh ka qenë bashkësia ligjore dhe, për pasojë, është ndarë ndërmjet meje dhe ish-bashkëshortit në pjesë të barabarta”.*

1.8.4 Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë nëse ish-bashkëshorti ka pasur pasuri të tjera të paluajtshme të regjistruara në emrin e tij gjatë periudhës së martesës. Gjithashtu, subjekti iu kërkua që të vinte në dispozicion të Komisionit një kopje të dokumentacionit për blerjen e kësaj/këtyre pasurie/pasurive, nëse do të kishte.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e saj, ka deklaruar se: *“Në dijeninë time gjatë kohëzgjatjes së martesës ish-bashkëshorti nuk ka pasur pasuri të tjera të regjistruara në emër të tij”.*

1.8.5 Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë nëse ish-bashkëshorti ka pasur likuiditete bankare në emër të tij gjatë periudhës së martesës. Gjithashtu iu kërkua të vinte në dispozicion një kopje të dokumentacionit që provon vlerat e këtyre likuiditeteve, nëse do kishte të tilla.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e saj, ka deklaruar se: *“Në dijeninë time, gjatë kohëzgjatjes së martesës ish-bashkëshorti ka pasur likuiditete bankare të cilat i përkisnin llogarisë së pagës në ‘Raiffeisen Bank’ sh.a. Bashkëlidhur me këtë dokument, do ju dërgoj dokumentacionin që i përket kësaj llogarie, dokumentacion që më është vënë në dispozicion prej tij. Në lidhje me likuiditete të tjera në llogari bankare të tjera nuk më ka treguar të ketë”.*

1.8.6 Komisioni i kërkoi subjektit të vërë në dispozicion burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie dhe mundësitë financiare të ish-bashkëshortit dhe prindërve të tij, si dhe iu kërkua informacion që të provojë në mënyrë më të detajuar lidhur me veprimet financiare të kryera për sigurimin e burimeve të nevojshme për blerjen e kësaj pasurie.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e saj, ka deklaruar se: *“Në dijeninë time, sipas deklarimeve që më kanë dhënë ish-bashkëshorti dhe prindërit e tij, ai dhe i ati kanë qenë të bashkëpunësuar në aktivitetin e tyre tregtar, që kryhej në qytetin e Beratit, aktivitet i cili kishte disa objekte veprimtarie, konkretisht kryhej në tre njësi tregtare, me objekte veprimtarie të ndryshme, njëra prej të cilave ka qenë autoshkollë, një ka qenë pikë tregtimi gazi me pakicë dhe tjetra tregtim veshje ceremoniale. Nëna e tij ka punuar si para viteve 1990 dhe deri në fund të vitit 1999 në Postën Shqiptare sh.a.*

Aktiviteti i tyre tregtar ka filluar që prej vitit 1992 në një objekt të ndërtuar prej tyre, me leje ndërtimi gjatë viteve 1991 - 1992, me sip. 64m², në pronësi të tyre, ku ndodheshin tre njësi tregtare dhe aktiviteti i tyre tregtar është kryer nga ish-bashkëshorti dhe i ati. Dokumentacioni i Drejtorisë së Tatimeve Berat për periudhën deri në mars të vitit 1997 është djegur, po ashtu edhe dokumentacioni i Bashkisë Berat dhe i Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, bashkëngjitur edhe shkresë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat në lidhje me këto ngjarje. Deri në mes të vitit 2001 ish-bashkëshorti ka qenë emigrant klandestin në Greqi, Itali dhe Gjermani dhe ka krijuar të ardhura, të cilat gjithashtu janë administruar nga prindërit e tij, duke qenë se kanë punuar bashkë. Pas emërimit tim në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë, në tetor 2001, kemi menduar të jetojmë në qytetin e Vlorës dhe prindërit e ish-bashkëshortit kanë marrë përsipër që për shkak të kontributit të tij në aktivitetin e përbashkët t’i blinin banesën në këtë qytet, që sipas informacioneve të tyre kushtonin rreth 3.500.000 lekë. Kjo shumë na është dhënë kur kemi gjetur shtëpi në qytetin e Vlorës rreth vitit 2003, në kohë të

ndryshme, dhe përbëhej nga çmimi i shitjes së shtëpisë në qytetin e Beratit, dhe diferenca, shuma të cilat kishin qenë pjesë e kontributit të ish-bashkëshortit në ekonominë e tyre familjare, nëpërmjet emigracionit apo punës së përbashkët”.

Lidhur me këtë deklaram, Komisioni konstatoi se subjekti nuk arriti të provonte mundësitë financiare të prindërve të ish-bashkëshortit për krijimin e burimit të ligjshëm të shumës 3.500.000 lekë, nga ku shuma 3.000.000 lekë është deklaruar për blerjen e pasurisë apartament.

1.8.7 Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë se sa ka qenë pjesa takuese dhe përfituese e ish-bashkëshortit nga shitja e pasurisë apartament në qytetin e Beratit në vitin 2001, si dhe të vërë në dispozicion një kopje të kontratës së shitblerjes.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e saj, ka deklaruar se: *“Në dijeninë time nga shitja e apartamentit në qytetin e Beratit, ish-bashkëshorti ka përfituar të gjithë shumën e shitjes. Bashkëngjitur me këtë dokument, sipas kërkesës tuaj, do ju vë në dispozicion një kopje të kontratës së shitjes datë 17.4.2001”.*

1.8.8 Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë nëse familja e ish-bashkëshortit ka blerë pasuri të paluajtshme pas shitjes së apartamentit në qytetin e Beratit në vitin 2001 dhe sa ka qenë vlera e blerjes/blerjeve të saj.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e saj, ka deklaruar se: *“Nuk jam në dijeni personalisht të veprimeve të tyre financiare ndër vite. Pas ardhjes së këtij pyetësi jam përprjekur të kontaktoj dhe më kanë informuar se pas shitjes së apartamentit në qytetin e Beratit në datën 17.4.2001, nuk kanë blerë pasuri të tjera, deri në vitin 2007.”*

1.8.9 Lidhur me këtë deklaram, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk i është përgjigjur plotësisht saktë pyetjes gjatë pyetësorit. Bazuar në përgjigje të rezultateve të hetimit rezultoi se prindërit e ish-bashkëshortit kanë blerë dy pasuri të paluajtshme. Konkretisht, me kontratën noteriale nr. *****, datë 14.4.2001, kanë blerë apartament banimi me sip. 88 m², me nr. pasurie *****, të ndodhur në rrugën “*****”, pallatet “*****”, shkalla *****, kati i *****, apartamenti *****, në shumën 1.000.000 lekë, periudhë e cila përkon me shitjen e pasurisë apartament në Berat. Gjithashtu, rezultoi se me kontratën noteriale nr. *****, datë 15.7.2000, kanë blerë në Durrës njësi tregtare me sip. 15,6m², kundrejt shumës 500.000 lekë.

1.8.10 Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë se ku janë mbajtur të ardhurat e përfituara nga veprimtaria ekonomike e familjes së ish-bashkëshortit të saj, si dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Berat nga viti 2001 deri në blerjen e kësaj pasurie të përbashkët apartament, në vitin 2006.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e saj, ka deklaruar se: *“Në lidhje me vendin ku i mbante të ardhurat nga aktiviteti tregtar familja e ish-bashkëshortit, unë personalisht nuk jam në dijeni. Për shkak edhe të marrëdhënieve aktuale me ta, kohës së gjatë të kaluar, e kam të pamundur të marr informacion të saktë dhe të plotë në lidhje me këtë pyetje.”*

Në lidhje me shumën prej 3.500.000 lekësh, që prindërit i kanë dhënë ish-bashkëshortit, i është dhënë në pjesë të ndryshme, në kohë të ndryshme, sipas mundësive të tyre dhe prej nesh është mbajtur aty ku kemi qëndruar ose në të afërm, sipas rastit, pasi që prej vitit 2002 kemi qenë në kërkim të një banese në qytetin e Vlorës. Për shkak të kohës së gjatë të kaluar nuk mund të jem e saktë në lidhje me këtë pyetje”.

1.8.11 Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë se kur ka filluar ta përdorë dhe ta ketë në zotërim këtë pasuri, duke vënë në dispozicion kopje të kontratave dhe librezave me OSHEE-në dhe UKT-në.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e saj, ka deklaruar se: “Apartamenti na është dorëzuar në vitin 2004, rreth muajit korrik të këtij viti. Deri në fillim të vitit 2005 kemi përshtatur atë për banim dhe mund ta kemi përdorur rreth fundit të vitit 2004, fillimit të vitit 2005. Në lidhje me këtë mund të vë në dispozicion informacion nga OSHEE-ja që kontrata për furnizimin me energji elektrike është lidhur në shkurt të vitit 2005 në emirin tim. Bashkëngjitur shkresë nga sistemi i menaxhimit të abonentëve të OSHEE sh.a., në lidhje me këtë pyetje. Nuk disponoj aktualisht librezat me OSHEE sh.a. apo Ujësjiellësin”.

1.9 Komisioni i rikërkoi sqarime subjektit lidhur me këtë pasuri, pasi në përgjigje të pyetësorit nr. 2⁴ nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë provues lidhur me burimin dhe mundësitë financiare të ish-bashkëshortit për krijimin e shumës prej 3.000.000 lekësh.

Konkretisht subjektit iu kërkua të deklaronte:

- Mund të deklaroni dhe provoni me dokumentacion shkresor shterues burimin e ligjshëm dhe mundësitë financiare të bashkëshortit për krijimin e shumës prej 3.000.000 lekësh në vitin 2005?
- Mund të deklaroni nëse keni pasur ndonjë çështje (gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtares) ose lidhje direkte apo indirekte, ju ose bashkëshorti juaj me shoqërinë “*****” apo me ortakun e vetëm të shoqërisë, shtetasin L.Gj?
- Mund të deklaroni pse duket se keni pasur trajtim preferencial lidhur me blerjen e kësaj pasurie pasi çmimi për m², nuk duket se është në përputhje me vlerat e tregut të shitblerjes së pasurive të paluajtshme në këtë zonë?
- Mund të deklaroni si e keni përdorur këtë pasuri të paluajtshme nga viti 2004 deri në momentin e blerjes së kësaj pasurie në vitin 2006. Çfarë kontrate apo marrëveshje keni pasur me pronarin e kësaj pasurie për përdorim me apo pa kundërshpërbim gjatë kësaj periudhe?

1.10 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 3⁵, ka deklaruar:

“Familja e ish-bashkëshortit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj shume, pasi:

- Nëna e ish-bashkëshortit ka qenë në marrëdhënie pune në shtet nga data 1.10.1973 deri në nëntor të vitit 1999. Në gusht të vitit 1994 nëna e ish-bashkëshortit ka pasur pagë mujore 7.840 lekë, ndërkohë që paga minimale për të njëjtën periudhë ka qenë 2.560 lekë, pra trefishin e pagës minimale.
- Babai i ish-bashkëshortit ka qenë në marrëdhënie pune në shtet nga gushti i vitit 1967. Nga gushti i vitit 1973 ka qenë i punësuar inxhinier mekanik, duke qenë disa periudha drejtor i SMT-së Berat.
- Të paktën që nga data 1.6.1993 babai i ish-bashkëshortit ka qenë i vetëpunësuar, duke qenë inxhinier mekanik, si inxhinier autoskolle, deri në fund të vitit 1996. Në vitin 1997, pasi qetësimi të sigurisë publike, ka filluar përsëri aktivitetet tregtar deri më 31.12.2004. Më tej, aktiviteti i tyre tregtar ka vazhduar në Tiranë, pasi në Berat ka punuar ish-bashkëshorti im për vitet 2003, 2004 dhe një pjesë të vitit 2005.
- Ish-bashkëshorti ka qenë emigrant klandestin disa herë dhe të ardhurat e siguruara i kanë administruar prindërit e tij, duke i përfshirë në aktivitetet e tyre tregtar zgjerimin e tij, blerjen e automjeteve në funksion të këtij aktiviteti etj.

⁴ Shihni përgjigjet e dërguara nga subjekti sipas pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

⁵ Shihni pyetësorin nr. 3 dhe përgjigjet e subjektit, në dosjen e Komisionit.

Prindërit e ish-bashkëshortit kanë ndërtuar një objekt tregtar në qytetin e Beratit, që prej mesit të vitit 1992 ka qenë funksional dhe aty kanë ushtruar aktivitetin tregtar si autoshkollë, shitje me pakicë e gazit dhe pajisjeve që përdorin gaz, si dhe tregtim, dhënie me qira veshjesh ceremoniale, për dasma. Ky aktivitet është ushtruar deri në vitin 2009. Dega e Tatim-Taksave Berat deklaroi që dokumentacioni i kësaj zyre është djegur në vitin 1997, për pasojë nuk kam mundësi të paraqes dokumentacion për periudhën 1993 – 1997, por nga dokumentacioni i sigurimeve shoqërore vërtetohet vetëpunësimi i babait të ish-bashkëshortit.

*Deklaroj se kam pasur një gjykim me shoqërinë ‘****’ sh.p.k., me vendimin nr. ***, datë 19.9.2003, vendim i cili ka marrë formë të prerë, i paankimuar nga palët. Nuk kemi pasur lidhje direkte apo indirekte, as unë as ish-bashkëshorti im, në dijeninë time me ortakun e vetëm të shoqërisë, shtetasin L.Gj.*

Në vlerësimin tim nuk kam pasur trajtim preferencial, pasi në të njëjtin pallat çmimi për metër katror ka qenë pothuajse i njëjtë, në disa raste më i ulët. Bashkë me këtë dokument ju dërgoj disa kontrata të lidhur për të njëjtin pallat.

Siç kam deklaruar në pyetësorët e tjerë, apartamenti më është dorëzuar në vitin 2014. Kjo pasi në vitin 2004 kam kryer pagesën e plotë të apartamentit. Nga dita që kam kryer pagesën e plotë të apartamentit, kam përdorur këtë pasuri. Fillimisht për ta bërë të përshtatshëm për banim, më pas për të banuar. Posedimi faktik ka filluar rreth fundit të vitit 2004.

Në deklaratën para fillimit të detyrës, e cila është plotësuar më 29.3.2004, kam deklaruar në total para në cash në datën 29.3.2004, të ish-bashkëshortit, në shumën 3.500.000 lekë. Deklarimi është bërë sipas shpjegimeve që ai më ka dhënë, në lidhje me shumën cash që ne posedonim në datën 29.3.2004”.

1.11 Komisioni gjatë hetimit për këtë pasuri konstatoi:

1.11.1 Nga përgjigjet dhe provat e sjella nga subjekti nuk arrihet të provohet mundësia financiare për krijimin e burimit të ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 3.000.000 lekë.

1.11.2 Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003 subjekti ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve: (a) shumën 2.100.000 lekë – Banka e Kursimeve – puna; (b) shumën 400.000 lekë – Berat – kthim nga vjehri; (c) shumën 1.000.000 lekë – emigracioni i bashkëshortit.

1.11.3 Ky deklaram për burimet financiare në deklaratën e vitit 2003 nuk përputhet me deklaratën *Vetting* të bërë nga subjekti në vitin 2017.

1.11.4 Subjekti ka pasqyruar kontradikta lidhur me pronësinë dhe bashkëpronësinë e deklaruar mbi këtë pasuri. Nga njëra anë subjekti ka deklaruar se pasuria është krijuar vetëm nga bashkëshorti dhe nga ana tjetër ka qenë palë kontraktore për blerjen e saj dhe e ka regjistruar në bashkëpronësi 50 % me 50 % me ish-bashkëshortin.

1.11.5 Subjekti nuk ka sqaruar se si ish-bashkëshorti ka përfituar të gjithë vlerën e shitjes së pasurisë apartament në Berat në shumën prej 1.650.000 lekësh (sipas deklaramit kanë qenë bashkëpronarë ish-bashkëshorti dhe prindërit e tij, por bazuar në kontratën e shitjes ai nuk rezultoi as bashkëpronar dhe as palë shitëse e pasurisë në fjalë) në vitin 2001, si dhe nuk ka shpjeguar dhe provuar se ku kanë jetuar ish-bashkëshorti dhe prindërit e tij pas shitjes së pasurisë ku jetonin, si dhe pasuri të tjera të blera në vijim. Në lidhje me pasuritë e blera nga prindërit e ish-bashkëshortit pas shitjes së banesës në Berat, subjekti nuk ka deklaruar saktë në pyetësorin nr. 2, duke mos deklaruar se në të njëjtën periudhë kanë blerë një pasuri në Durrës në vlerën prej 1.000.000 lekësh.

1.11.6 Në vitin 2003 rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar një çështje gjyqësore me palë paditëse shoqërinë “*****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori L. Gj dhe të paditur G.Sh etj., me objekt gjyqësor “detyrimi i palës së paditur për përmbushje detyrimi lidhur me kontratën e shkëmbimit të truallit, të ndodhur në lagjen “*****”. Subjekti, me anë të këtij vendimi (nr. ***, datë 19.9.2003), ka vendosur pranimin e kërkesës së palës paditëse, shoqërisë “*****” sh.p.k., e cila është shoqëria që subjekti ka blerë apartament në vitin 2006 dhe që e deklaruar se e ka zotëruar që në vitin 2004.

1.11.7 Subjekti ka deklaruar se në vitin 2004 ka përdorur pasurinë apartament të shoqërisë “*****” sh.p.k., e cila duket se lidhet indirekt me procesin gjyqësor të vitit 2003 ku subjekti ka dhënë vendim në favor të saj. Në deklaratën periodike vjetore të viteve 2004 dhe 2005 subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e kësaj pasurie apartament nga ana e saj. Në përgjigje të pyetësorit subjekti ka deklaruar se ka përdorur pasurinë apartament në pronësi të kësaj shoqërie, pa kundërshtpërblim, nga viti 2004 deri në vitin 2006. Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar se *kanë gjetur shtëpi në qytetin e Vlorës rreth vitit 2003*, ndërsa më pas ka deklaruar se *pagesat për këtë pasuri i ka bërë një herë në vitin 2004 dhe një herë në vitin 2005*. Pra, subjekti nuk ka qenë e saktë në deklaram dhe ka qenë kontradiktore lidhur me gjetjen, përdorimin dhe likuidimin e shumës për blerjen e kësaj pasurie.

1.11.8 Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit është para një konflikti të interesit me shoqërinë “*****” sh.p.k. Subjekti ka pasur proces gjyqësor me këtë shoqëri në fund të vitit 2003, duke pranuar kërkesëpadinë e saj dhe disa muaj më vonë ka përfituar dhe përdorur pasurinë në pronësi të kësaj shoqërie, nga viti 2004 – 2006, pa kundërshtpërblim. Gjithashtu, ajo nuk arriti të provojë pagesën e pretenduar të kryer ndaj shoqërisë “*****” sh.p.k. në vitin 2005 për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme në shumën prej 3.000.000 lekësh.

1.11.9 Referuar Udhëzimit Nr. 5, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2006”, rezultoi se kostoja mesatare e ndërtimit (për sipërfaqe ndërtimit) për qytetin e Vlorës është 27.283 lekë/m², ndërsa referuar të dhënave në tregun e lirë, po sipas këtij udhëzimi, rezultoi se kostoja e shitjes në qytetin e Vlorës është 48.156/m². Referuar koston së shitjes në tregun e lirë vlera e kësaj pasurie me sip. 102,22 m² do ishte në shumën 4.922.506 lekë. Pra, rezultoi se vlera e blerjes së kësaj pasurie është nën vlerën e tregut dhe në dukje ka çmim preferencial.

1.12 Analiza e mundësisë së dhënies së shumës 3.500.000 lekë nga prindërit e shtetasit E. Gj

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura S + A, vitet 1994 - 2002	1,501,758
Të ardhura nga shitja e pasurisë në Berat në vitin 2001	1,650,000
Të ardhura totale S + A	3,151,758
Shpenzime jetese St + A, vitet 1994 - 2002	1,229,927
Dhënë z. E. Gj, viti 2003	3,500,000
Shpenzime totale S + A	4,729,927
Pamundësia për dhënie 3,500,000 lekë	-1,578,169

1.12.1 Bazuar në analizën financiare, Komisioni konstatoi se prindërit e ish-bashkëshortit të subjektit nuk kishin mundësi financiare për dhënien e shumës së pretenduar prej 3.500.000

lekësh. Në këtë analizë nuk janë përfshirë as pasuritë e blera nga prindërit e ish-bashkëshortit në shumën totale prej 1.500.000 lekësh në vitet 2000 - 2001.

1.12.2 Llogaritja e të ardhura të prindërve është bërë nga Komisioni bazuar në dokumentacionin e sjellë nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve (shihni në vijim metodologjinë e përdorur nga Komisioni për analizën financiare).

1.13 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri, si vijon:

- *Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm dhe mundësitë financiare për blerjen e kësaj pasurie vetëm nga të ardhurat e ish-bashkëshortit dhe familjes së tij.*
- *Prindërit e ish-bashkëshortit të subjektit kanë qenë në pamundësi financiare për dhënien e shumës së pretenduar prej 3.500.000 lekësh.*
- *Subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratat periodike vjetore të dorëzuar në ILDKPKI për vitet 2004 dhe 2005.*
- *Subjekti ka bërë deklarime kontradiktorë lidhur me burimin e shumës së pretenduar prej 3.500.000 lekësh, bazuar në deklaratën Vetting, deklaratën para fillimit të detyrës së vitit 2003 dhe në përgjigje të pyetësorit.*
- *Subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë shitblerjeje të kësaj pasurie si bashkëpronare dhe e ka regjistruar në bashkëpronësi, ku ka deklaruar edhe 50% të bashkëpronësisë së saj (subjekti ka deklaruar pjesën takuese prej 50% si në deklaratën Vetting, ashtu dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006).*
- *Subjekti nuk ka sqaruar se si ish-bashkëshorti ka përfitur të gjithë vlerën e shitjes së pasurisë në Berat në shumën 1.650.000 lekë, në vitin 2001 (pasi nuk ka qenë as bashkëpronar as palë shitëse e pasurisë në fjalë), si dhe nuk ka shpjeguar se ku kanë jetuar ish-bashkëshorti dhe prindërit e tij pas shitjes së pasurisë ku jetonin dhe pasuritë e tjera të blera në vijim.*
- *Subjekti të shpjegojë bindshëm pse prindërit e ish-bashkëshortit kanë shitur banesën në Berat në vitin 2001, të deklarojë se ku kanë jetuar dhe çfarë pasurie tjetër kanë blerë më pas, pse të gjithë vlerën e përfitur nga shitja ia kanë dhënë ish-bashkëshortit, i cili nuk ka qenë as bashkëpronar i pasurisë së shitur, si i ka disponuar dhe ruajtur këto të ardhura deri në vitin 2006, ku i ka përdorur për blerjen e pasurisë apartament në bashkëpronësi 50%.*
- *Subjekti ka përdorur pasurinë apartament nga viti 2004 deri në vitin 2006, pa kundërshpërblim, duke mos përcaktuar saktë me çfarë statusi (marrëdhënien juridiko-civile) e ka përdorur pasurinë e paluajtshme, si dhe nuk ka deklaruar përdorimin dhe të drejtat reale të përfituara nga kjo pasuri në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004-2006.*
- *Subjekti i rivlerësimit ka pasur në proces dhe ka shqyrtuar një çështje gjyqësore me palë paditëse shoqërinë e ndërtimit "*****" sh.p.k. në vitin 2003, kundër pronarëve të truallit ku do ndërtohej një pallat, duke i dhënë të drejtë kësaj shoqërie. Disa muaj më pas, në vitin 2004, subjekti ka përfitur apartament për të njëjtin objekt që ka pasur në procesin gjyqësor në vitin 2003, e finalizuar me kontratë shitblerjeje në vitin 2006. Subjekti ka qenë në konflikt interesi me shoqërinë "*****" sh.p.k.*

- Subjekti nuk ka deklaruar gjendjen cash dhe ndryshimet (shitesat dhe pakësime në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004 - 2006), likuiditete të cilat janë deklaruar si burim për blerjen e pasurisë apartament.
- Referuar vlerave në tregun e lirë për blerjen e banesave në vitin 2006 (Udhëzimi i Këshillit të Ministrave për vitin 2006) në qytetin e Vlorës, subjekti ka pasur një çmim favorizues për blerjen e kësaj pasurie, pasi vlera e saj me sip. 102 m², në tregun e lirë do rezultonte në shumën 4.922.506 lekë.
- Subjekti ka qenë në pamundësi financiare për blerjen e pasurisë apartament në vitin 2006 në shumën -1.578.169 lekë.

1.14 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka deklaruar se:

“Kundërshtoj konkluzionet e mësipërme si vijon: Komisioni padrejtësisht nuk ka përfshirë në të ardhurat e familjes shumën prej 3.500.000 lekë si të ardhura të bashkëshortit për kohën që ka jetuar së bashku me familjen e tij për periudhën 1993 - 2002. Pasuria ime në datën e përpilimit të deklaratës ka qenë 3.500.000 lekë, të cilat kanë qenë ‘para cash’, të cilat i kishim në banesë dhe ishin të ish-bashkëshortit. Shuma me të cilën është blerë apartamenti i sipërcituar ka qenë pasuri e ish-bashkëshortit, pasi prindërit e tij ia kanë dhënë si kontribut i tij në ekonominë familjare. Familja e ish-bashkëshortit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj shume. Analiza e Komisionit është e gabuar për shkak se prindërit e ish-bashkëshortit kanë kryer aktivitet tregtar. Vlerësoj se në këtë rast jam në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 sipas të cilit: ‘Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Vlerësoj se duhet të merren parasysh nga ana e Komisionit provat indirekte, të cilat janë shkresa zyrtare, me vlerë të plotë provuese, dhe nga të cilat provohet që babai i ish-bashkëshortit ka ushtruar aktivitet tregtar si biznes i vogël.

Për sa i përket konstatimit se nga ana ime nuk është deklaruar kjo shumë në vitet 2004 dhe 2005, ky është konstatim i drejtë. Nuk kam deklaruar pasuri të deklaruara më parë, pasi kështu e kam kuptuar formularin e deklaratës.

Në lidhje me vlerën e pasurisë, e përcaktuar nga Komisioni në masën 4.922.506 lekë, sipas tregut të lirë, vlerësoj se nga kontratat që unë kam paraqitur për shitblerjen e apartamenteve të të njëjtit pallat, çmimi ka qenë i përafërt.

*Për sa i përket konstatimit të Komisionit për konflikt interesi me shoqërinë ‘****’, konstatoj se është i gabuar. Për sa i përket çështjes civile të shqyrtuar prej meje, nga përmbajtja e vendimit nr. ****, datë 19.9.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, i dhënë prej meje, vendim i cili ka marrë formë të prerë, i paankimuar nga palët, ka pasur lidhje me një pallat të ndërtuar, të përfunduar, i cili ndodhet në lagjen ‘****’, Vlorë, pranë Portit. Pallati ku kam blerë apartamentin është një pallat që ndodhet në lagjen ‘****’, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.*

*Nuk kam qenë në konflikt interesi, pasi apartamenti është blerë, dorëzuar dhe përdorur prej meje më shumë se një vit pasi kam dhënë vendimin nr. ****, datë 19.9.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.*

*Çështja që unë kam gjykuar ka përfunduar në shtator të vitit 2003. Në kohën e gjykimit të saj, ndërmjet meje dhe shoqërisë ‘****’ nuk ka pasur asnjë marrëveshje, për pasojë në kohën e*

shqyrtimit të çështjes, nuk kam pasur asnjë rast të konfliktit në dukje të interesit, apo konflikt tjetër interesi⁶”.

1.15 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti nuk paraqiti shpjegime dhe prova për të kundërshtuar dhe rrëzuar gjetjet e Komisionit për pasurinë apartament me sip. 102,22 m², të ndodhur në lagjen “*****”, Vlorë.

1.16 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë për këtë pasuri, nuk justifikon me burime të ligjshme blerjen e saj, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka qenë në konflikt interesi me palën shitëse, duke blerë pasurinë apartament nën çmimin e tregut dhe përdorur pa kundërshtpërblim për rreth 2 vjet, duke u ndodhur në kushtet e germës “d”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

2. Automjet tip “Volkswagen Golf”, me targa *****

Hetimi i kryer nga Komisioni

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë automjet tip “Volkswagen Golf”, me targa *****.

Burimi i krijimit: kursimet. Çmimi i blerjes: 100.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

2.1 Rezultoi se me kontratën e shitblerjes nr. *****, datë 5.5.2016, subjekti ka blerë automjetin tip “Volkswagen Golf”, me targa *****, nga pala shitëse S. K. Çmimi i përcaktuar në kontratë rezultoi në shumën 100.000 lekë.

2.2 Për këtë pasuri në emër të saj, subjekti është pajisur më pas me dokument pronësie.

2.3 DPSHTRR-ja ka konfirmuar automjetin në pronësi të subjektit të rivlerësimit, me targa *****, e regjistruar në DRSHTRR-në Vlorë.

2.4 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *automjet tip “Volkswagen Golf”, me targa *****, blerë në datën 5.5.2016, në shumën 100.000 lekë me burim nga kursimet.*

2.5 Rezultoi se ky automjet është blerë nga shtetasi T. M në vitin 2014 në vlerën 4.000 euro dhe një vit më pas është blerë nga shtetasja S.K në vlerën 2.000 euro, e cila ia ka shitur më pas subjektit të rivlerësimit në vlerën 100.000 lekë. Referuar shitjeve të mësipërme, si dhe të dhënave publike në faqen e internetit, vlera e automjetit është në dukje preferenciale dhe nuk rezulton që një automjet me karakteristika të tilla të jetë në shumën 100.000 lekë.

2.6 Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore përkatëse pakësim të gjendjes *cash* (burimi dhe ligjshmëria e së cilës nuk vërtetohet ende), por referuar edhe deklaratave periodike ndër vite subjekti ka pasur pasaktësi në deklaram për gjendjen *cash* dhe ndryshimet e saj.

⁶ Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

2.7 Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit tip “Volkswagen Golf”, me targa *****

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura nga paga deri më 5.5.2016	513,541
Të ardhura në total	513,541
Shpenzime jetese deri më 5.5.2016	235,092
Shpenzime blerje me kartë debiti deri më 5.5.2016	77,207
Shpenzime udhëtimi deri më 5.5.2016	82,420
Shpenzime në total	394,719
Blerje automjeti, 5.5.2016	100,000
Shtim likuiditeti deri më 5.5.2016	257,887
Total pasuri	357,887
Pamundësi blerje automjet “Golf”, me targa *****	-239,064

2.7.1 Edhe pse vlera e automjetit është me çmim preferencial, bazuar në analizën financiare edhe duke marrë vlerën e tij në shumën 100.000 lekë, subjekti nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie nga kursimet në vitin 2016. Në analizën financiare janë marrë të ardhurat e subjektit nga paga deri në momentin e blerjes së këtij automjeti. Në analizë për blerjen e kësaj pasurie nuk janë marrë në konsideratë kursimet e mundshme *cash* të subjektit nga vitet e mëparshme, për shkak se ajo nuk ka deklaruar ndryshimet e gjendjes *cash* (zvogëlimet) në deklaratat periodike vjetore përkatëse.

2.8 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri.

- Subjekti është në pamundësi financiare për krijimin e pasurisë automjet në vitin 2016.
- Subjekti nuk ka deklaruar ndryshimin e gjendjes *cash* në DPV-në e vitit 2016 dhe të viteve më parë.
- Çmimi i blerjes së kësaj pasurie është preferencial në raport me çmimet e mëparshme të blerjes së tij dhe të dhënave mbi çmimet e tregut.

2.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁷, subjekti ka deklaruar:

“Vlerësoj se nga ana e Komisionit janë llogaritur gabim shpenzimet për jetesë, duke qenë se nuk është mbajtur parasysh se çdo fundjavë fëmijët e mitur qëndrojnë me të atin, gjithashtu kanë qëndruar me të atin edhe në datat 2 dhe 3 maj të vitit 2016, në të cilat kam qenë jashtë shtetit.

Gjithashtu, në tabelën financiare nuk është përfshirë gjendja cash në shumën 300.000 lekë, që ka qenë gjendje në familje (banesë) e mbartur që nga viti 2007 (mbetur pas pakësimit të shumës cash prej 3.500.000 lekësh të deklaruar në vitet 2003, 2004 dhe 2005).

*Gjithashtu, në tabelën e analizës financiare është përfshirë zëri ‘shtim likuiditeti’, pa u përcaktuar çfarë përfaqëson konkretisht. Rezulton se në datën 8.4.2016 kam depozituar në llogarinë bankare në ‘Union Bank’, me emrin ‘*****’ shumën 50.000 lekë dhe në llogarinë bankare në ‘Union Bank’ me emrin ‘*****’ shumën 100.000 lekë. Këto shuma duhet të llogariten si shpenzim, duke qenë se kanë pakësuar likuiditetin e subjektit.*

Sipas kësaj llogaritjeje analiza financiare e kësaj pasurie del me rezultat pozitiv në vlerën 261.320 lekë.

⁷ Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

Në lidhje me blerjen e automjetit kam shpjeguar se burimi kanë qenë kursime të miat. Është e vërtetë që në deklaratën periodike të vitit paraardhës nuk kam deklaruar kursime në cash, por nuk kam bërë për asnjë moment deklaram të pakësimit të gjendjes cash të mbetur.

Gjithashtu, dua të shpjegoj se çdo person, në rast se mendon të kryejë një blerje të veçantë, nuk kryen shpenzime mesatare por kursen, duke kryer shpenzime të nevojshme. Kjo është sjellje e përgjithshme njerëzore.

Po kështu, po të shikonim edhe gjendjen financiare në fund të vitit në llogarinë rrjedhëse të 'Tirana Bank', rezulton se në fund të vitit kam pasur si likuiditet shumën 116.190 lekë, shumë kjo që nuk gjen pasqyrim fare në tabelën financiare.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit se çmimi i automjetit është preferencial, vlerësoj se është i gabuar, pasi vlera e automjetit ka qenë në zbritje nga momenti i blerjes, për shkak të cilësive të tij.

Si konkluzion, kam pasur mundësi të kursej në datën 5.5.2016 shumën 100.000 lekë për blerjen e një automjeti popullor, tip 'Golf', vit prodhimi 2004".

2.10 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti nuk paraqiti shpjegime dhe prova bindëse për të kundërshtuar dhe rrëzuar gjetjet e Komisionit për blerjen e pasurisë automjet në vitin 2016.

2.10.1 Lidhur me pretendimet e subjektit për zbritje të shpenzimeve të jetesës për fëmijët, pasi sipas vendimit nr. ****, datë 5.12.2013, të gjykatës për zgjidhjen e martesës ata qëndrojnë me të atin në fundjavë dhe dy javë në vit, Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka qenë e saktë. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit, ka deklaruar se ish-bashkëshorti ishte shkëputur gradualisht nga banesa ku kishin jetuar së bashku. Gjithashtu, ajo deklaroi në përgjigje pyetësorit nr. 3 se ish-bashkëshorti i takonte fëmijët në po këtë banesë (apartamenti në rr. "*****") meqenëse kishte ambiente të bollshme. Për më tepër, subjekti deklaroi se edhe aktualisht takimet me fëmijët ish-bashkëshorti i kryente në banesën e saj.

2.10.2 Lidhur me pretendimet e subjektit për gjendjen *cash* nga viti i kaluar, e cila ka shërbyer për blerjen e automjetit, Komisioni, në analizën financiare, merr parasysh ndryshimet e kursimeve *cash* të deklaruara në deklaratat periodike vjetore. Subjekti nuk deklaroi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 pakësim të kursimeve *cash* për blerjen e këtij automjeti (detyrim ky që rrjedh nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003).

2.10.3 Lidhur me paqartësinë e subjektit për ndryshimet e likuiditetit, Komisioni sqaron se ky zë përfshin ndryshimin e likuiditeteve (bankë + kursime *cash*) për periudhën 31.12.2015 – 5.5.2016. Ndërkohë, gjendjet e likuiditeteve në banka janë domosdoshmërisht pjesë e analizës financiare, ndryshe nga pretendimi i subjektit. Ndryshimi i likuiditeteve llogaritet pikërisht si diferenca mes gjendjeve të tyre nga një moment kohor në tjetrin.

2.11 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë pasuri dhe nuk justifikon me burime të ligjshme blerjen e saj, sipas përcaktimeve të gurmës "b", të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

3. Depozitë bankare në "Union Bank"

Hetimi i kryer nga Komisioni

3.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitë bankare në shumën 150.629 lekë, në "Union Bank", Vlorë.

Burimi i krijimit: kursimet. Pjesa takuese: 100 %.

3.2 Për këtë depozitë subjekti ka paraqitur kopje të ekstraktit bankar të llogarisë personale nr. ***** në “Union Bank”, për periudhën 1.12.2010 – 22.12.2016. Gjendja e llogarisë në datën 22.12.2016 është në shumën 150.629 lekë.

3.3 “Union Bank” ka konfirmuar gjendjen e llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit, ku në emër të saj, në datën 23.1.2017, rezulton shuma prej 150.651 lekësh.

3.4 Rezultoi se kjo depozitë bankare është hapur në datën 5.1.2015, në vlerën 30.000 lekë. Subjekti ka kryer veprime të ndryshme në këtë depozitë, të cilat janë reflektuar në analizën financiare.

3.5 Sipas përgjigjes së pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se kjo depozitë është krijuar fillimisht me paratë që i ka dhënë i ati për detyrimin ushqimor dhe vlerat monetare që i kanë dhuruar të afërmit.

3.6 Subjekti nuk ka provuar mundësitë e ish-bashkëshortit për të ardhurat e krijuara pas divorcit, si dhe mundësitë financiare të tij për shlyerjen e detyrimeve që lindin nga zbatimi i vendimit gjyqësor (për detyrimin ushqimor).

3.7 Rezultoi se kjo depozitë është hapur në datën 5.1.2015. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 gjendje *cash* për krijimin e kësaj depozite bankare. Nëse këtë gjendje subjekti e kishte si kursime, kishte detyrimin t’i deklaronte në DPV-në përkatëse.

3.8 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar mundësitë dhe burimin e ligjshëm për krijimin e kësaj depozite bankare në vitin 2015.

3.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar:

*“Gjatë vitit 2015 janë krijuar dy depozita bankare në ‘Union Bank’, depozita bankare me emrin *****, në shumën 30.000 lekë, dhe depozita bankare me emrin ***** në shumën 72.700 lekë. Të dyja depozitat janë llogari kursimi, në të cilat janë depozituar kursime nga detyrimi për ushqim i fëmijëve të mitur ose dhurata që fëmijëve të mitur u kanë bërë të afërmit, gjyshërit, halla, tezja, etj., me rastin e festave, ditëlindjeve etj.*

*Është e vërtetë që në fund të vitit 2014 nuk kam deklaruar kursime, por depozitat janë krijuar me dhuratat e Vitit të Ri, kursimet që fëmijët i kanë pasur në kasat e kursimit të tyre personale, të dhëna nga i ati, apo nga gjyshërit nga i ati, të cilat në fund të vitit 2014 nuk kam pasur dijeni shifrën konkrete. Shumat e depozituara në mars kanë qenë pjesë të detyrimit për ushqim për vitin 2015, të dhënë nga ish-bashkëshorti *cash*, dorëzuar nëpërmjet fëmijëve. Në lidhje me mundësinë e ish-bashkëshortit për këto të ardhura, jam shprehur në pjesën që i përket të ardhurave nga pensioni ushqimor.*

*Rezulton se në fund të vitit 2014 kam pasur likuiditet në ‘Tirana Bank’ në shumën 100.121 lekë, shumë kjo që nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni, e cila nuk gjen pasqyrim në tabelën financiare. Ajo që është më e rëndësishme, në fillim të vitit 2015 kam pasur edhe në fakt gjendje *cash* në shumën 500.000 lekë, që është mbartur si e pandryshuar nga viti 2007 dhe për të cilën nuk kam pasur detyrim që të ta deklaroja në DPV-në periodike, për sa kohë nuk kishim pakësim të saj. Është e vërtetë se edhe në fund të vitit 2015 nuk është deklaruar pakësim i kësaj shume, por në konceptin tim kjo shumë dhe shuma e depozitave është konsideruar si mosndryshim i bilancit financiar të likuiditetit në familje, pasi ajo ka mbetur e pandryshuar në total (300.000 + 200.000).*

*Vlerësoj se në analizën financiare të vitit 2015 duhet të përfshihet shtesa e depozitave me emrin **** dhe ****, në shumat respektive 70.000 lekë dhe 27.300 lekë, pasi këto shuma i përkasin kursimeve nga të ardhurat e vitit 2015. Shumat 30.000 lekë dhe 72.700 lekë, me të cilat këto depozita kanë filluar, duhet të përfshihen në analizën financiare të vitit 2014.*

Në lidhje me konstatimin e Komisionit për mundësitë dhe burimin e ligjshëm për krijimin e këtyre depozitave bankare në vitin 2015, çmuj se nisur nga vlera e vogël e tyre, të dyja së bashku kanë filluar me vlerën 100.000 lekë, fakti se që në emërtim të tyre mbajnë emrat e fëmijëve të mitur, fakti që janë krijuar në datën 5.1.2015, pra në fillim të vitit, dhe pas festave të fundvitit, shpjegimi im se burimi i krijimit të tyre rrjedh nga të ardhurat e vitit të mëparshëm dhe nga dhuratat që fëmijët kanë marrë nga të afërmit dhe i nga i ati për festa, është i logjikshëm dhe i mundshëm”.

3.10 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk paraqiti shpjegime dhe prova bindëse për të kundërshtuar dhe rrëzuar gjetjet e Komisionit për këtë depozitë bankare.

3.10.1 Komisioni i konsideron të ligjshme të ardhurat nga pensioni ushqimor i caktuar nga vendimi gjyqësor nr. ****, datë 5.12.2013, meqenëse ky është një detyrim ligjor për ish-bashkëshortin. Por në deklarin periodik vjetor të vitit 2014 subjekti nuk deklaroi shtim të kursimeve *cash* që të mund të shtohen si rritje likuiditetesh në analizën financiare. Gjithashtu, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 nuk deklarohet pakësim i kursimeve *cash* si burim për krijimin e kësaj depozite (detyrim ky që rrjedh nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003).

3.10.2 Gjendjet e likuiditeteve në banka janë pasqyruar si pjesë e analizës financiare, ndryshe nga pretendimi i subjektit. Ndryshimi i likuiditeteve llogaritet pikërisht si diferenca mes gjendjeve të tyre nga një moment kohor në tjetrin.

3.11 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për këtë pasuri dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e saj, sipas përcaktimeve të gurmës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

4. Depozitë bankare në “Union Bank”

Hetimi i kryer nga Komisioni

4.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitë bankare në shumën 200.716 lekë, në “Union Bank”, Vlorë.

Burimi i krijimit: kursimet. Pjesa takuese: 100 %.

4.2 Për këtë, subjekti ka paraqitur ekstrakt bankar të llogarisë personale nr. *****, në “Union Bank”, për periudhën 1.12.2010 – 22.12.2016. Gjendja e llogarisë në datën 22.12.2016 është në shumën 200.716 lekë.

4.3 “Union Bank” ka konfirmuar gjendjen e kësaj llogarie bankare në emër të subjektit të rivlerësimit, e cila në datën 23.1.2017 rezulton në shumën 200.745 lekë.

4.4 Rezultoi se kjo depozitë bankare është hapur në datën 5.1.2015, në shumën 72.700 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime të ndryshme në këtë depozitë, të cilat janë reflektuar në analizën financiare.

4.5 Sipas përgjigjes së pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se kjo depozitë është krijuar fillimisht me paratë që i ka dhënë ish-bashkëshorti për detyrimin ushqimor dhe vlerat monetare që i kanë dhuruar të afërmit.

4.6 Subjekti nuk ka provuar mundësitë e ish-bashkëshortit për të ardhurat e krijuara pas divorcit, si dhe mundësitë financiare të tij për shlyerjen e detyrimeve që lindin nga zbatimi i vendimit gjyqësor (për detyrimin ushqimor).

4.7 Rezultoi se kjo depozitë është hapur në datën 5.1.2015. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 gjendje *cash* për krijimin e kësaj depozite bankare. Nëse këtë gjendje subjekti e kishte si kursime, kishte detyrimin për t'i deklaruar në DPV-në përkatëse.

4.8 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar mundësitë dhe burimin e ligjshëm për krijimin e kësaj depozite bankare në vitin 2015.

4.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi⁸ njësoj si për depozitën bankare të sipërcituar në pikën 3 të këtij vendimi.

4.10 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk paraqiti shpjegime dhe prova për të kundërshtuar dhe rrëzuar gjetjet e Komisionit për këtë depozitë bankare.

4.10.1 Komisioni i konsideron të ligjshme të ardhurat nga pensioni ushqimor i caktuar nga vendimi gjyqësor nr. ****, datë 5.12.2013, meqenëse ky është një detyrim ligjor për ish-bashkëshortin. Por në deklarin periodik vjetor të vitit 2014 subjekti nuk deklaroi shtim të kursimeve *cash* që të mund të shtohen si rritje likuiditetesh në analizën financiare. Gjithashtu, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 nuk deklarohet pakësim i kursimeve *cash* si burim për krijimin e kësaj depozite (detyrim ky që rrjedh nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003).

4.10.2 Gjendjet e likuiditeteve në banka janë pasqyruar si pjesë e analizës financiare, ndryshe nga pretendimi i subjektit. Ndryshimi i likuiditeteve llogaritet pikërisht si diferenca mes gjendjeve të tyre nga një moment kohor në tjetrin.

4.11 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për këtë pasuri dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e saj, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

5. Depozita bankare në “Tirana Bank” dhe “Union Bank”

Hetimi i kryer nga Komisioni

5.1 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision:

- *Account Statement* “Tirana Bank”, datë 23.1.2017, në emër të znj. Klodiana Gjyzari, me gjendje të llogarisë në shumën 227.652,36 lekë;
- nxjerrje llogarie datë 22.12.2016, në “Union Bank”, në emër të znj. Klodiana Gjyzari, me gjendje në datën 22.12.2016, në vlerën 0 (zero) lekë.

5.2 Të dy llogaritë bankare të mësipërme dhe vlerat e tyre të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit janë konfirmuar nga “Tirana Bank” dhe “Union Bank”.

5.3 Në përfundim të hetimit, Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me deklarinmet e subjektit për këto llogari bankare.

6. Pasuritë dhe të ardhurat e ish-bashkëshortit

Hetimi i kryer nga Komisioni

6.1 Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003, subjekti ka deklaruar pasuritë si vijon:

⁸ Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

1. automjet tip "Renault", në vlerën 1.000.000 lekë;
2. automjet tip "Honda", në vlerën 600.000 lekë;
3. gjendje cash: (a) 2.100.000 lekë – Banka e Kursimeve; (b) 400.000 lekë – Berat – kthim nga vjehrri; (c) 1.000.000 lekë – emigracioni.

6.2 Në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2003, subjekti ka deklaruar dy pasuri të luajtshme, automjete të blera përkatësisht në shumat 1.000.000 lekë dhe 600.000 lekë.

6.3 Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive dhe likuiditeteve⁹ dhe i kërkoi që të vinte në dispozicion kopje të kontratës së blerjes së automjeteve, si dhe të deklaronte burimin e ligjshëm për blerjen e tyre.

6.4 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar:

"Në lidhje me këto pasuri, në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2003 kam deklaruar që kanë qenë pasuri individuale të ish-bashkëshortit. Kjo për shkak se janë blerë me të ardhurat e punës së tij, si dhe janë përdorur për qëllimet e punës së tij, nuk kanë qenë automjete që përdoreshin për nevoja të familjes.

Deklarimi në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2003 në të gjitha rubrikat që i përkisnin ish-bashkëshortit dhe pasurive në lidhje me të, janë plotësuar sipas shpjegimeve që ai më ka dhënë.

*Dy ose tre vjet më pas, nuk më kujtohet, pas një verifikimi të kryer në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit është kryer një rishikim i kësaj deklarate, për shkak të mospërputhjeve. P.sh., në lidhje me automjetin 'Renault', sipas deklaramit që më ka dhënë ish-bashkëshorti, kam shkruar vlera: 1.000.000 lekë, burimi: kontratë dhurimi, gjë që është e pasaktë, pasi një automjet me vlerë të përcaktuar nuk buron nga kontratë dhurimi. Ndërkohë që ky automjet është blerë me kontratën nr. *****, datë 11.6.2003, nga shtetasi P.S në vlerën 200.000 lekë. Sipas shpjegimeve të ish-bashkëshortit në periudhën kur është verifikuar kjo deklaratë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, vlera e këtij automjeti, duke qenë se prej tij janë kryer riparime në këtë automjet, është vendosur impiant gazi, është kryer pagesa e doganës, sipas tij automjeti vlente 1.000.000 lekë. Kjo pasaktësi është sqaruar në ILDKPKI, duke dorëzuar një kopje të kontratës së blerjes, të cilën ua vë në dispozicion edhe juve.*

*Ky automjet është shitur me kontratën nr. *****, datë 8.6.2004, te shtetasi V. S, kundrejt shumës 700.000 lekë. Edhe kjo kontratë është dorëzuar në ILDKPKI.*

Në lidhje me automjetin e deklaruar prej meje në vlerën 600.000 lekë, nuk disponoj kontratën e blerjes. Siç kam shpjeguar më lart, edhe ky automjet ka qenë pronë individuale e ish-bashkëshortit dhe sipas deklarimeve të tij nuk e ka kontratën dhe nuk e mban mend personin të cilit ia ka blerë.

*Me kontratën nr. *****, datë 27.7.2004, edhe ky automjet është shitur. Ish-bashkëshorti ia ka shitur vëllait të tij kundrejt shumës 400.000 lekë. Këtë kontratë e disponoj, në rast se vlerësoni se është e nevojshme ua dërgoj.*

Të dyja këto automjete kanë pasur si burim blerje shumat e siguruara nga ish-bashkëshorti nga aktiviteti tregtar. Edhe burimi i këtyre pasurive është verifikuar nga ILDKPKI-ja dhe e kam dorëzuar për të vërtetuar burimin e të ardhurave vërtetim datë 26.1.2006, të lëshuar nga Dega e Tatim-Taksave Berat. Një kopje të këtij vërtetimi e disponoj".

⁹ Shihni analizën financiare të prindërve të ish-bashkëshortit G. Gj, më sipër, lidhur me mundësisë për të dhënë shumën prej 3.500.000 lekësh.

6.5 Në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2003, subjekti ka deklaruar të ardhurat të ish-bashkëshortit në shumën 2.100.000 lekë, si të ardhura nga puna (në Bankën e Kursimeve), në shumën 400.000 lekë, Berat. Burimi i krijimit: kthim nga vjehri dhe shuma 1.000.000 nga emigracioni i ish-bashkëshortit.

6.6 Subjektit iu kërkua të vinte në dispozicion dokumentacion provues lidhur me burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave (vërtetim për të ardhurat dhe pagimin e detyrimeve përkatëse) të ish-bashkëshortit.

6.7 Në lidhje me llogarinë e deklaruar tek ish-Banka e Kursimeve, ju kërkua subjektit që të paraqiste dokumentacion provues për krijimin e kësaj llogarie, destinacionin e saj, si dhe veprimet bankare të kryera mbi këtë llogari.

6.8 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar:

“Në tërësi shuma prej 3.500.000 lekësh, e deklaruar në vitin 2004, ka qenë shuma që prindërit i kanë dhënë ish-bashkëshortit. Ish-bashkëshorti im ka pretenduar se kontributi i tij në punën e përbashkët ka qenë 2.100.000 lekë dhe 1.000.000 lekë, të ardhura të tij nga emigracioni nuk duhet të quheshin të dhëna nga prindërit pasi sipas tij kanë qenë të tijat. Në lidhje me shumën 400.000 lekë, ajo ka qenë pjesë e shumës 3.500.000 lekë, të cilën prindërit e ish-bashkëshortit na e kishin kërkuar për disa muaj dhe na e kishin kthyer atë periudhë.

Për të sqaruar mosmarrëveshjet e tyre, ish-bashkëshorti dhe prindërit e tij kanë bërë deklaratën noteriale datë 26.10.2016. Nga deklaratimet e nënës së ish-bashkëshortit, në periudhën që kam plotësuar deklaratën datë 29.3.2004, shuma prej 2.100.000 lekësh para se të na e jepnin, e kanë pasur në Bankën e Kursimeve dhe e kanë tërhequr në vitin 1999, por nuk ka dokumentacion, pasi ka kaluar kohë shumë e gjatë dhe nuk kishte arsye logjike për ta ruajtur, sa kohë që llogaria ishte mbyllur. Është e qartë në përmbajtjen e deklaratës fillestare datë 29.3.2004, se kam deklaruar se kam “lekë cash” në shumën 3.500.000 lekë, Banka e Kursimeve ka qenë vendi ku kanë qenë më parë këto para. Të ardhura të ish-bashkëshortit nuk kam deklaruar shumën 3.500.000 lekë, kjo shumë është deklaruar në zërin ‘likuiditete’, ‘lekë në cash’. Të ardhura të ish-bashkëshortit për vitin 2003 kam deklaruar në zërin ‘të ardhura’, shumën 1.100.000 lekë, e cila rrjedh nga aktiviteti tregtar biznes i vogël, për të cilin kam dërguar me përgjigjet e pyetësorit të kaluar një kopje të vërtetimit të Zyrës së Tatim-Taksave Berat, të vitit 2005, një kopje e të cilit është depozituar në periudhën përkatëse edhe në ILDKPKI”.

6.9 Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion dhe nuk ka rezultuar që ish-bashkëshorti të ketë krijuar të ardhura të ligjshme deri në fund të vitit 2003, kur janë deklaruar këto pasuri.

6.10 Përveç këtyre pasurive të deklaruara në DPV-në e vitit 2003, ish-bashkëshorti i subjektit rezultoi se kishte blerë edhe një automjet tip “BMW” në vitin 2002, në vlerën 301.214 lekë (përfshirë shpenzimet doganore). Ky automjet është shitur më pas në vitin 2003 në vlerën 200.000 lekë. Subjekti nuk vërtetoi burimin e ligjshëm të blerjes së kësaj pasurie e cila nuk është deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2003.

6.11 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar mundësitë dhe burimin e ligjshëm për këto pasuri.

6.11.1 Komisioni konstatoi se subjekti nuk provoi vlerën e blerjes së pasurisë automjet tip “Honda” në vlerën 600.000 lekë, deklaruar në deklaratën e vitit 2003 në ILDKPKI.

6.11.2 Subjekti nuk ka pasur mundësi financiare¹⁰ dhe nuk arriti të provojë krijimin e pasurive:

¹⁰ Shihni analizën financiare të Komisionit.

- a. automjet tip “Renault” në vlerën 1.000.000 lekë;
- b. automjet tip “Honda” në vlerën 600.000 lekë; dhe
- c. gjendje *cash*: shuma 2.100.000 lekë – Banka e Kursimeve; shuma 400.000 lekë – Berat – kthim nga vjehri; shuma 1.000.000 lekë – emigracioni.

6.11.3 Deklarimi i gjendjes *cash* në vitin 2003 nuk përkon me deklarin e subjektit në deklaratën *Vetting*.

6.11.4 Subjekti nuk ka pasur mundësi financiare dhe nuk arriti të provojë burimet e ligjshme për blerjen e automjetit tip “BMW” në vitin 2002 në vlerën 301.214 lekë.

6.12 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar:

“Në lidhje me konstatimet e mësipërme shpjegoj se, në lidhje me shumën 3.500.000 lekë, deklaruar si ‘likuiditet cash’ në banesë në datën e deklarinimit të vitit 2003, kjo shumë ka qenë e ish-bashkëshortit dhe i është dhënë nga prindërit. Për sa i përket konstatimit të Komisionit se përgjigjet në lidhje me këtë shumë janë kontradiktore, vlerësoj se nuk janë të tilla. Kam deklaruar se kjo shumë prej 3.500.000 lekësh i është dhënë ish-bashkëshortit nga prindërit e tij.

Në lidhje me çfarë përfaqëson kjo shumë, kam qenë e qartë, ajo përfaqëson kontributin e ish-bashkëshortit në ekonominë e përbashkët me prindërit e tij, deklarim ky i marrë nga subjektet përkatës, ish-bashkëshorti dhe prindërit e tij. Vendi ku këto shuma janë mbajtur në kohë të ndryshme ka qenë i ndryshëm, në datën 31.3.2004, kur është plotësuar deklarata fillestare e pasurisë, kjo shumë ka qenë në banesën ku unë jetoja, ndaj është deklaruar si ‘likuiditet cash’ në banesë. Kjo shumë na është dhënë në periudha të ndryshme, sipas mundësisë së prindërve të ish-bashkëshortit. Në lidhje me mundësinë e prindërve të ish-bashkëshortit për kursimin e kësaj shume kam dhënë shpjegime në analizën e krijimit të pasurisë apartament banimi. Pasi kam analizuar mundësitë financiare të prindërve të ish-bashkëshortit për të krijuar të ardhura nga aktiviteti i tyre tregtar, kam shpjeguar se më 17.4.2001 kanë shitur një apartament në qytetin e Beratit kundrejt çmimit 1.650.000 lekë. Gjithashtu, në vitin 2001 kanë shitur një njësi tregtare në qytetin e Durrësit, kundrejt çmimit 300.000 lekë. Kanë shitur një automjeti furgon, tip ‘Fiat Dukat’. Gjithashtu kanë vijuar aktivitetin tregtar gjatë periudhës 1993 – 2002, duke realizuar të ardhura të mjaftueshme, pasi provohet që kanë blerë pasuri të paluajtshme, apartament banimi në Tiranë, si dhe një njësi tregtare në qytetin e Durrësit. Analizën e hollësishme të mundësisë së prindërve të ish-bashkëshortit e kam kryer në pjesën që i përket pasurisë apartament banimi, pasi me shumën 3.500.000 lekë është blerë pikërisht ky apartament.

Për sa i përket automjetit BMW, vlerësoj se nga ana e Komisionit është kryer gabim analiza financiare e viteve 1998 - 2002, dhe konkluzioni se nuk kemi pasur burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti është e gabuar (për më tepër shihni analizën financiare të bërë në vijim për periudhën 1998 – 2002). Të ardhurat nga shitja e këtij automjeti janë përdorur për blerjen e automjeteve të tjera në vitin 2003 dhe në deklaratën e vitit 2003 nuk janë deklaruar sepse ishin konsumuar për blerjen e automjeteve”.

6.13 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti nuk paraqiti shpjegime dhe prova bindëse për të kundërshtuar dhe rrëzuar gjetjet e Komisionit për këtë pasuri dhe likuiditete.

6.14 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti pretendoi që meqenëse analiza e periudhës 1998 – 2003 është me rezultat pozitiv, atëherë nga kjo rezulton se subjekti dhe ish-bashkëshorti kishin mundësi të ligjshme të blerjes së automjetit tip “BMW” në vitin 2002. Nëse reflektojmë uljen e shpenzimeve të jetesës për periudhën 1998 – 2002, vërtet rezultati i kësaj periudhe del pozitiv, por subjekti kishte deklaruar në pyetësor se automjeti është blerë me të ardhurat e ish-

bashkëshortit. Ndërkohë, në periudhën 1998 – 2002 nuk provohet ligjshmëria e të ardhurave të tij, kështu që automjeti rezultoi me burim të ligjshëm ende të paprovuar.

6.15 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe kontradiktor për pasuritë si më sipër dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurisë automjet tip “BMW”, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

7. Automjet tip “Nissan Patrol”

Hetimi i kryer nga Komisioni

7.1 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, subjekti ka deklaruar blerje të pasurisë automjet tip “Nissan Patrol” në vlerën 250.000 lekë.

7.2 Subjekti është pyetur si është bërë e mundur blerja e kësaj pasurie në këtë vlerë, kur vetëm për shpenzimet për detyrimet doganore janë paguar gati dyfishi i vlerës së blerjes së saj.

7.3 Gjithashtu, subjektit iu kërkua të vërë në dispozicion dokumentacion provues lidhur me burimin e ligjshëm të blerjes së kësaj pasurie, si dhe të deklarojë si është e mundur që pasi është përdorur kjo pasuri për rreth 9 vjet është shitur në vitin 2019 disa herë më shumë se vlera e blerjes së saj, në çmimin 700.000 lekë.

7.4 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar:

“Në lidhje me këtë pasuri nuk jam në dijeni sa kanë qenë detyrimet doganore, pasi nga përmbajtja e kontratës mjete ka qenë i targuar. Jam në dijeni që shitësi ka qenë shok i ngushtë me ish-bashkëshortin dhe fqinj me ne. Burimi i blerjes së kësaj pasurie, siç kam shkruar në deklaratën e pasurisë për vitin 2010, rrjedh nga të ardhura të deklaruara më parë. Disa vjet më parë ish-bashkëshorti ka shitur dy automjete dhe të ardhurat e nxjerra prej tyre kanë shërbyer për blerjen e automjetit ‘Benz’ në vitin 2004 dhe diferenca për blerjen e mjetit ‘Nissan’. Theksoj që ish-bashkëshorti ka pasur marrëdhënie shoqërore të ngushta me shitësin dhe për afekcion kanë përcaktuar çmimin e vendosur në kontratë.

Në lidhje me vlerën e shitjes në vitin 2019, vij në dijeni për këtë fakt prej pyetësorit tuaj që ky mjet është shitur dhe nuk e di sa mund të jetë vlera e tij reale, dhe nuk mund të përgjigjem. Ndoshta vlera reale ka qenë 700.000 lekë, nuk kam dijeni për çmimet e automjeteve. Nga kjo vlerë nuk kam përfituar gjë, për këtë shkak nuk kam pasur interes të hetoj në lidhje me fatin e automjetit. Në deklaratën për likuidimin e regjimit martesor kemi përcaktuar se nuk kemi pasur pasuri të tjera në regjim martesor. Unë kam pasur pasuri personale depozitën bankare në ‘Union Bank’, ish-bashkëshorti ka pasur automjetin ‘Nissan’. Nuk kemi pasur pretendime reciproke në lidhje me këto pasuri individuale”.

7.5 Komisioni konstatoi se subjekti dhe ish-bashkëshorti kanë përfituar një çmim preferencial për blerjen e pasurisë automjet tip “Nissan”, në vlerën 250.000 lekë.

7.6 Subjekti nuk ka deklaruar shtim kursimesh në vitin 2004, në periudhën kur ka shitur dy automjetet e tjera, “Honda” dhe “Renault”. Gjithsesi, subjekti nuk arriti të vërtetojë as burimin e ligjshëm të blerjes së këtyre dy automjeteve. Për sa i përket kursimeve *cash* të deklaruara, subjekti nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të krijimit të tyre.

7.7 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar mundësitë dhe burimin e ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie.

7.7.1 Subjekti nuk ka provuar mundësitë për blerjen e kësaj pasurie nga burime të ligjshme dhe në deklaratat periodike vjetore (2004 – 2010) nuk ka deklaruar gjendjen *cash* dhe ndryshimet e saj.

7.7.2 Subjekti nuk shpjegoi bindshëm çmimin preferencial të deklaruar për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2010 në vlerën 250.000 lekë dhe shitjen në vitin 2019 në vlerën 700.000 lekë.

7.7.3 Subjekti nuk ka pasur mundësi financiare dhe nuk arriti të provojë krijimin e shumës 250.000 lekë për blerjen e kësaj pasurie.

7.8 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar:

“Automjeti ‘Nissan’ është blerë me të ardhurat e siguruara nga shitja e automjeteve të mëparshme. Nga analiza financiare e të gjitha viteve rezultoj me diferencë pozitive, të rrjedhur nga të ardhurat e ligjshme të pagës. Në lidhje me mosdeklarimin në deklaratat periodike të shumave të mbetura nga të ardhura të deklaruara më parë, ka qenë një gabim i imi i vazhdueshëm, i paqëllimtë.

Në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të fituara nga shitja e automjeteve ‘Renault’ dhe ‘Honda’ kam dhënë shpjegime në rubrikën ‘analiza financiare e vitit 2003’.

Nga analiza financiare e vitit 2009, i cili është viti paraardhës, edhe sipas llogaritjeve të kryera nga Komisioni rezultoj me një diferencë pozitive, më shumë se vlera e automjetit ‘Nissan’.

Për sa i përket çmimit të sendit, sipas shpjegimeve të ish-bashkëshortit: se ‘ish-bashkëshorti ka pasur marrëdhënie shoqërore të ngushta me shitësin, i cili ka qenë edhe fqinj me ne, dhe për afekcion kanë përcaktuar çmimin e vendosur në kontratë’.

Në lidhje me vlerën e shitjes prej 700.000 lekësh në vitin 2019, nuk kam përfituar nga shitja e këtij automjeti, pasi ka qenë një pasuri e cila i përkiste ish-bashkëshortit. Në deklaratën për likuidimin e regjimit martesor, kemi përcaktuar se nuk kemi pasur pasuri të tjera në regjim martesor. Unë kam pasur pasuri personale depozitën bankare në ‘Union Bank’, ish-bashkëshorti ka pasur automjetin ‘Nissan’. Nuk kemi pasur pretendime reciproke në lidhje me këto pasuri individuale”.

7.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti nuk paraqiti shpjegime dhe prova bindëse për të kundërshtuar dhe rrëzuar gjetjet e Komisionit për këtë pasuri të luajtshme.

7.10 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këto pasuri dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurisë automjet tip “Nissan”, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

8. Depozitë bankare në “Union Bank”

Hetimi i kryer nga Komisioni

8.1 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 subjekti ka deklaruar depozitë në shumën 550.000 lekë në “Union Bank”, dërguar nga shtetasja R. O nga “Raiffeisen Bank” (ku i kishte lënë për ruajtje).

8.2 Në lidhje me këtë depozitë subjektit iu kërkua të sqarojë burimin e krijimit të kësaj shume, pse nuk është deklaruar në deklaratat periodike të mëparshme, si dhe pse nuk është deklaruar lënia në ruajtje e kësaj shume prej saj.

8.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar:

“Kjo shumë është deklaruar në vlerën 470.000 lekë të tërhequr nga Banka Amerikane. Pas tërheqjes e kam lënë tek motra në ruajtje, pasi ka qenë depozitë e imja, pa dijeninë e ish-bashkëshortit dhe nuk kam dashur t’ia tregoj. Kjo shumë më është dërguar nga motra me

transfertë bankare nga 'Raiffeisen Bank' ku motra ka pasur llogari bankare në 'Union Bank', ku me qëllim pritjen e kësaj shume kam hapur një llogari. Bashkë me shumën 470.000 lekë, kam lënë edhe kursime të tjera të vogla në vite motrës, kursime të cilat nuk kanë qenë në dijeni të ish-bashkëshortit.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 kam shpjeguar se kjo shumë është deklaruar në deklaratat e mëparshme dhe vendi ku i kisha ka qenë motra, jo në banesën time, mënyra e deklarimit ka qenë me transfertë bankare nga 'Raiffeisen Bank'. Kam deklaruar që burimi kanë qenë deklarime të mëparshme, pasi kam deklaruar depozitimin e tyre në Bankën Amerikane në vitin 2005, kam deklaruar tërheqjen e tyre në vitin 2006 dhe diferenca prej 80.000 lekësh ka qenë kursime nga pagat, të cilat gjithashtu i kam deklaruar. Nuk e dija që duhet ta deklaroja çdo vit, sa kohë që e kisha deklaruar një herë, po ashtu dhe pagat janë të deklaruara dhe nuk kam deklaruar pakësim të kësaj shume. Në këtë mënyrë e kam kuptuar formularin”.

8.4 Gjithashtu rezultoi se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, subjekti ka deklaruar depozitë në shumën 460.881 lekë, në Bankën Amerikane, Vlorë.

8.5 Në lidhje me këtë, subjektit iu kërkua të deklarojë burimin e kësaj depozite, si dhe të paraqesë një kopje të *statement-it* bankar.

8.6 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar:

*“Burimi janë kursime të miat personale nga pagat, të cilat deri në kohën e depozitimit merreshin cash. Kopje të *statement-it* nuk kam pasi ka qenë kohë e largët dhe nuk kam ruajtur dokumentacion pasi kjo llogari është mbyllur prej meje në vitin 2006. Një pjesë të kësaj shume ia kisha dhënë hua një shoqeje të asaj periudhe, e cila kur ma ktheu kishte depozitë në Bankën Amerikane dhe ma ktheu nëpërmjet kësaj banke, për këtë shkak edhe unë i kam depozituar bashkë me huan e kthyer edhe pjesën tjetër të kursimeve në të njëjtën bankë.”*

8.7 Në lidhje me depozitën prej 451.265 lekësh në ish-Bankën Amerikane, të deklaruar në DPV-në e vitit 2005, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit.

8.8 Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka deklaruar:

“Kjo llogari depozite është hapur në vitin 2005 dhe hapja e saj është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, dorëzuar në mars të vitit 2006. Llogaria është mbyllur në datën 18.10.2006 dhe mbyllja e saj është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, dorëzuar në mars të vitit 2007.

Sipas vërtetimit datë 19.11.2020, të lëshuar nga 'Intesa Sanpaolo Bank', kjo llogari është çelur në datën 8.6.2004, në shumën 451.265 lekë, është kaluar në depozitë me afat 6-mujor dhe më 18.10.2006 shuma e depozitës prej 470.755 lekësh, principal + interesa depozite është tërhequr dhe llogaria është mbyllur në këtë datë.

Burim i kësaj llogarie kanë qenë të ardhurat e mia të një viti më parë, të cilat janë deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, siç edhe kam deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, dorëzuar në mars të vitit 2006.

Një pjesë të këtyre të ardhurave, konkretisht shumën 151.265 lekë, ia kisha dhënë hua një shoqeje të asaj periudhe gjatë vitit 2004. Duke qenë se shoqja ime kishte llogari tek Banka Amerikane, Vlorë, huan ma ka kthyer nëpërmjet kësaj banke, jo cash. Për këtë shkak, kursimet e mia të tjera nga të ardhurat e vitit 2004, në vlerën 300.000 lekë, i kam depozituar në këtë bankë, duke çelur llogari depozite, në mënyrë që shoqja ime të mos paguante komision që t'i dërgonte në një bankë tjetër.

Pas tërheqjes së saj, duke qenë se e kisha deklaruar shumën, nuk mendoja se duhet ta rideklaroja, kam menduar se pasuritë e deklaruara më parë nuk rideklaroreshin.

Bashkë me përgjigjet dhe vërtetimin datë 19.11.2020, të lëshuar nga 'Intesa Sanpaolo Bank' të cituar më lart”.

8.9 Në datën 18.10.2006 subjekti ka deklaruar se ka tërhequr nga kjo depozitë shumën 470.755 lekë dhe pretendon që këto i ka lënë në ruajtje tek e motra, znj. R. O.

8.10 Në DPV-në e vitit 2006 nuk deklarohet as lënia në ruajtje e këtyre parave tek ndonjë person tjetër dhe as si kursime *cash*. Në analizën financiare e gjithë shuma e tërhequr nga depozita u konsiderua nga Komisioni si shpenzim i atij viti.

8.11 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar mundësitë dhe burimin e ligjshëm për krijimin e kësaj depozite bankare.

8.11.1 Shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi nga njëra anë ka deklaruar se ka qenë depozitë e saj pa dijeninë e ish-bashkëshortit dhe nga ana tjetër ka deklaruar se burimi për krijimin e kësaj depozite kanë qenë të ardhurat e ish-bashkëshortit dhe prindërve të tij (kjo sipas deklaratës periodike vjetore të vitit 2005).

8.11.2 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* nga të ardhurat e saj. Të vetme kursime *cash* subjekti ka deklaruar në vitin 2003 të ardhura të bashkëshortit, por dhe për ato burime është në pamundësi financiare.

8.11.3 Subjekti nuk ka deklaruar ndryshimin e gjendjes *cash* (në deklaratat periodike vjetore të viteve 2006 - 2010) për shumën e tërhequr në bankë dhe as dhënien në ruajtje të kësaj shume motrës së saj.

8.11.4 Subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* në deklaratën e viteve 2003 dhe 2004, si dhe as huan e dhënë dhe të kthyer nga mikja e saj në vitin 2006.

8.12 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar:

“Në lidhje me konstatimet e mësipërme shpjegoj se depozita e krijuar në 'Union Bank' në vitin 2010 është krijuar me kursimet në vite që kam pasur unë personalisht, të cilat përbëhen nga shuma e tërhequr nga depozita në Bankën Amerikane dhe diferenca e kursime të viteve pasuese. Në lidhje me depozitën e krijuar në Bankën Amerikane kam dhënë shpjegime tek analiza financiare e vitit 2005, kur kjo depozitë është krijuar. Siç edhe kam deklaruar, shuma 550.000 lekë më është nisur me transfertë bankare nga motra, e cila i kishte të depozituara te 'Raiffeisen Bank'. Në rast se doja të fshihja burimin e kësaj shume, mund të kisha deklaruar dhuratë nga motra, duke qenë se ajo m'i ka nisur me transfertë bankare dhe nga ekstrakti i llogarisë së saj tek kjo bankë ka pasur të depozituara shuma të konsiderueshme. Por nuk i jam fshehur të vërtetës, duke shpjeguar se kjo shumë nuk është dhuratë nga motra, por janë kursimet e mia deri në vitin 2010, kursime që kanë rrjedhur vetëm nga paga ime dhe nuk kanë lidhje me të ardhurat e ish-bashkëshortit, siç nuk kanë pasur lidhje të ardhurat e ish-bashkëshortit nga shitja e automjeteve me mua. Në një farë mënyre kemi pasur pasuri të ndara, këtë kam shpjeguar kur kam deklaruar se këto kursime, kjo depozitë, nuk kanë qenë të njohura për bashkëshortin. Nuk mund të them se kemi qenë familje model, fakt i provuar me zgjidhjen e martesës.

Në lidhje me mungesën e deklarimit të shumës së kursyer ndër vite, siç kam shpjeguar më lart, kam menduar se duke qenë se kjo shumë është deklaruar në vitin 2006, kur kam mbyllur depozitën, nuk kisha nevojë ta ridekloroja. Mendoj se deklarimet e mia duhet të vlerësohen të vërteta nga Komisioni, pasi, siç shpjegova më lart, vazhdimisht në të njëjtën mënyrë e kam plotësuar deklaratën, duke kuptuar që pasuritë, shumat e deklaruara më parë, nuk duhet të ridekloroheshin. Gjithashtu motra ma ka nisur nëpërmjet bankës shumën 550.000 lekë dhe mund të kisha deklaruar se m'i kishte bërë dhuratë, por kjo nuk do të përbente fakt të vërtetë.

Pra, në lidhje me këtë depozitë, vlerësoj se duhet të konsiderohet si e krijuar me burime të ligjshme”.

8.13 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këto pasuri, si dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e kësaj depozite, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

9. ANALIZA FINANCIARE

9.1 Subjekti rezultoi në pamundësi financiare për vitet 2003 - 2016 në shumën prej -9.613.467 lekësh.

9.2 Komisioni përfshiu në analizën financiare edhe deklaramet e subjektit të rivlerësimit lidhur me pagesën e ish-bashkëshortit për kontributin e tij si detyrim ushqimor për vitet 2014 - 2016, por i kërkoi subjektit dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij për vitet 2014 -2016.

9.3 Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

9.3.1 Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të “Raiffeisen Bank”, “Tirana Bank”, ish-Banka Amerikane, “Union Bank”, “Alpha Bank”, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

- i. të ardhurat nga pagat e subjektit në Shkollën e Magjistraturës (1998 – 2000), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës (2000 – 2001), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë (2001 – 2014) dhe Gjykatën e Apelit Vlorë (2015 – 2016);
- ii. të ardhurat nga interesi i “Tirana Bank” dhe “Union Bank” (2009 – 2016);
- iii. të ardhurat nga detyrimi ushqimor për fëmijët, mbështetur në vendimin nr. **** datë 5.12.2013, të gjykatës;
- iv. të ardhurat nga pagat e ish-bashkëshortit në Zyrën e Përmbarrimit (2005 – 2006), sipas vërtetimit të sjellë në përgjigje të rezultateve të hetimit;
- v. të ardhurat nga pagat e ish-bashkëshortit në Bashkinë Himarë (2007 – 2011).

Subjekti ka pretenduar të ardhura nga aktiviteti privat i ish-bashkëshortit, z. E. Gj, në periudhën 2003 – 2004, por nuk ka arritur të dokumentojë aktivitetin e tij dhe as realizimin e të ardhurave të ligjshme nga ky aktivitet.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

- i. Shpenzimet e jetesës bazuar në ato mujore për konsum sipas përbërjes së familjes (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i); shkresa nr. **** prot., datë 4.3.2019, e ILDKPKI-së, e administruar në dosjen e subjektit.
Subjekti paraqiti pretendime për zbritjen e shpenzimeve të jetesës, sipas secilës kategori të përfshirë në analizën financiare. Ky pretendim nuk merret parasysh, pasi Komisioni ka një praktikë të konsoliduar tashmë të llogaritjes së këtyre shpenzimeve. Për më tepër, shpenzimet e jetesës të cilat përdoren në analizën financiare janë shpenzime minimale, ndërkohë që shpenzimet e subjektit janë të një niveli më të lartë se ato të përdorura në analizë.
- ii. Shpenzime arredimi për vitet 2004, 2005, 2014 dhe 2015 sipas përgjigjes së subjektit në pyetësonin nr. 2 – për sa i përket këtyre shpenzimeve ka një mospërputhje mes deklarimeve të bëra në pyetësonin standard dhe deklarimeve të bëra në pyetëson.
- iii. Shpenzimet e qirasë gjatë stazhit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (2000 – 2001), si dhe shpenzimet e qirasë në Vlorë (2003 – 2004), deklaruar nga subjekti.
- iv. Shpenzimi i shumës prej 470.000 lekësh të tërhequr nga depozita tek ish-Banka Amerikane, viti 2006.
- v. Shpenzimet e transportit Berat - Vlorë për vitin 2002, të deklaruar nga subjekti në përgjigjet e pyetësorëve.
- vi. Shpenzimet për kampin veror të vajzës M. Gj (2015 – 2016).
- vii. Shpenzimi i shumës se tërhequr nga mbyllja e depozitës tek “Union Bank” në vitin 2016, deklaruar nga subjekti në përgjigjet e pyetësorëve.
- viii. Shpenzimet e arsimimit për fëmijët të deklaruar nga subjekti.
- ix. Shpenzimet e udhëtimit.

Metodologjia për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit është bërë duke iu referuar vendimit nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për subjektin E.I. Në rastet kur qëndrimi është deklaruar dhe vërtetuar me dokumentacion shkresor të familjarët e subjektit/bashkëshortit, nuk llogariten shpenzime qëndrimi. Nuk janë marrë në konsideratë

shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshorti kanë deklaruar dhe dokumentuar udhëtime për qëllime pune.

Disa shpenzime udhëtimit, për të cilat janë vënë re blerje biletash përmes transaksioneve bankare, janë përfshirë te shpenzimet e udhëtimit meqenëse vërtetohen nga *statement*-i bankar.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, subjekti ka deklaruar shpenzime për pushime familjare në vlerën 2.100 euro, të cilat Komisioni i ka konsideruar shpenzime të kryera për pushimet e deklaruara si të bëra në Antalia, Turqi (sipas përgjigjes në pyetësonin standard), aq më tepër që kjo vlerë është e krahasueshme me atë të deklaruar në deklarinin periodik vjetor të vitit 2015, ku deklarohen “shpenzime për pushime familjare në Antalia – shuma 2.178 euro”.

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive¹¹.

9.3.2 Për sa i përket të ardhurave të prindërve të ish-bashkëshortit, të cilat janë marrë parasysht në analizën e mundësisë së tyre për t'i dhënë shtetasit E. Gj shumën e pretenduar prej 3.500.000 lekësh, Komisioni është bazuar në vërtetimet e sjella nga subjekti në përgjigjet e pyetësorëve (dokumentacioni i plotë nga ISSH-ja për shtetasit S. J. Gj dhe A. N. Gj).

9.4 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për gjetjet e konstatuara nga Komisioni, si dhe për të provuar mundësitë dhe burimin e ligjshëm për krijimin e pasurive, ndryshimin e likuiditeteve ndër vite dhe përballimin e shpenzimeve të jetesës.

9.5 Subjekti ka kthyer përgjigje dhe ka paraqitur shpjegime¹² në lidhje me analizën financiare për periudhën 1998 – 2002. Janë marrë parasysht shpjegimet e subjektit dhe shpenzimet e jetesës për këtë periudhë, të cilat janë llogaritur nga Komisioni si vijon:

- vitet 1998 - 1999 – janë llogaritur shpenzime jetese vetëm për subjektin;
- viti 2000 – janë llogaritur shpenzime jetese për subjektin dhe ish-bashkëshortin meqenëse subjekti kishte deklaruar fillimin e bashkëjetesës në këtë vit;
- viti 2001 – janë llogaritur shpenzime jetese për subjektin dhe ish-bashkëshortin për një vit të plotë dhe për fëmijën e lindur në shtator për 4 muaj të këtij viti;
- viti 2002 – janë llogaritur shpenzime jetese për tre persona.

9.6 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për pasuritë e krijuara dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre duke zbritur edhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të gërmës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, DSIK-ja, pas verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e pikës 4 të nenit 4 dhe neneve 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur në Komision raportin përfundimtar me nr. **** prot., datë 7.12.2020, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ****, datë 9.12.2020, të KDZH-së, ku rezulton se:

- Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016.

¹¹ Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme në dosjen e ILDKPKI-së.

¹² Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit, faqe 27-68.

- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.
- Gjatë periudhës në të cilën znj. Klodiana Gjyzari ushtronte detyrën si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë disponohen të dhëna përpara dhe pas periudhës së rivlerësimit kalimtar, ku ngrihen dyshime për përfshirjen në veprimtari korruptive.
- Në disa të dhëna të vitit 2008 ka pasur dyshime se gjyqtarja Klodiana Gjyzari mund të ketë përfituar një sasi parash për të favorizuar shtetasin për të cilin ka pasur një çështje penale në ngarkim të tij.
- Për shtetasen Klodiana Gjyzari disponohen të dhëna ku ngrihen dyshime për përfshirjen në ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj sistemit të drejtësisë në Vlorë, me qëllim favorizimin e procesit civil/çështje pronësie ndaj ish-bashkëshortit të saj, shtetasit E. Gj.
- Gjatë vitit 2006 institucionet verifikuese kanë siguruar të dhëna për dyshime dhe marrëdhënie korruptive dhe përfitime të paligjshme në sistemin e drejtësisë pranë gjyqësorit Vlorë, ku znj. Klodiana Gjyzari dyshohet për bashkëpunim me kryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, z. A. M. Gjatë një procesi gjyqësor kryetari i gjykatës ka refuzuar një kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës Klodiana Gjyzari dhe me vendimin nr. ****, datë 3.2.2005, kjo gjyqtare ka pushuar çështjen për falsifikim të vendimit nr. ****, datë 17.7.1997, të KKKP-së Vlorë.
- Sipas informacioneve ekzistojë dyshime serioze dhe të arsyeshme të shpërdorimit të detyrës nga gjyqtarja Klodiana Gjyzari në dhënien e vendimit civil me nr. ****, datë 23.9.2005.
- Ka informacion me *indicie* për veprimtari të kundërligjshme në sistemin e drejtësisë në Vlorë për shtetasin E. Gj (ish-bashkëshorti i subjektit), si i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme në formën e ndikimit ndaj një gjyqtari në këtë qytet me qëllim favorizimin e një shtetasi kundrejt përfitimeve të paligjshme.
- Për subjektin e rivlerësimit merren parasysh elementët që evidentojnë përfshirjen e saj në veprimtari korruptive, pasi në frymën kundër korrupsion të ligjit nr. 84/2016 vlerësohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit.
- Veprimtaria korruptive e subjektit të rivlerësimit, në bashkëpunim, cenon drejtpërsëdrejti pastërtinë e figurës, çfarë përmbush plotësisht përcaktimet e germave “b” dhe “c” të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, ku znj. Klodiana B. Gjyzari vlerësohet si individ i mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale.

Në përfundim, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, është në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.

Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar mundësitë dhe burimin e ligjshëm mbi gjetjet lidhur me kriterin e figurës.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit lidhur me kriterin e figurës, subjekti ka deklaruar:

“Verifikimi i figurës së subjektit të rivlerësimit kryhet sipas neneve 37, 38 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, sipas të cilëve ‘grupi i punës, gjatë procedurave të kontrollit të figurës, duhet t’u përmbahet kërkesave të përgjithshme si më poshtë: (a) verifikimi i saktë i identitetit në të shkuarën dhe të tashmen për çdo individ; (b) verifikimi nëse ka tendenca kriminale për përfshirjen në krimin e organizuar; (c) vlerësimi i përgjithshëm nëse individ i mund të vihet nën presion nga struktura kriminale; (ç) kontrolli nëse ka qenë është ose tenton të angazhohet fshehurazi, vetëm, në bashkëpunim, ose në përbërje të një organizate kriminale’.

Sipas nenit 38: '1. Kontrolli i figurës zhvillohet bazuar në prova të sakta, në informacione konfidenciale, si dhe informacione të tjera të disponueshme. 2. Kontrolli i figurës zhvillohet në mënyrë objektive dhe pa ndikime të karakterit personal, armiqësor dhe miqësor, të cilat mund të favorizojnë ose disfavorizojnë subjektin e rivlerësimit. 3. Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6 dhe rrethanat lehtësuese, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të këtij neni. Vlerësimi duhet të përmbajë rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese të tij. Nëse vlerësimi nuk përmban elementet e parashikuara në këtë paragraf, konsiderohet i paplotë. 4. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, janë kur: (a) subjekti i rivlerësimit është fotografuar ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar; (b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jo rastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar; (c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar; (ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar; (d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës'.

Ndërsa në nenin 39 parashikohet se: 'Brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, pas përgatitjes nga Grupi i Punës të dokumentit/raportit, ia paraqet atë Komisionit. Ky dokument/raport përcakton nëse subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, nëse ka informacion në deklaramentit të tij ose gjetkë që tregon se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, si dhe konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë e tij për vazhdimin ose jo të detyrës. Ky dokument përmban informacion mbi kontaktet dhe kushtet e parashikuara në nenin 38 të këtij ligji. Informacioni nuk bëhet publik nëse ai rrezikon sigurinë e burimit, ose për shkak të një kushti të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër'.

Raporti nuk përmend asnjë kontakt të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parashikimeve të nenit 38 të ligjit, por pavarësisht faktit se nuk është konstatuar asnjë kontakt i asnjë lloji i subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë apo të dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar, nga ana e DSIK-së arrihet në konkluzionin se: 'Veprimtaria korruptive e subjektit të rivlerësimit, në bashkëpunim, cenon drejtpërsëdrejti pastërtinë e figurës, çfarë përmbush plotësisht përcaktimet e germave 'b' dhe 'c', të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, ku znj. Klodiana B. Gjyzari vlerësohet si individ i mundshëm për t'u vënë nën presion nga strukturat kriminale'.

Ky konkluzion është i gabuar, pasi nuk është konstatuar asnjë kontakt i subjektit të rivlerësimit me subjekte pjesë të strukturave kriminale, të provuara apo të dyshuara si të tilla.

Konstatohet se nga ana e Komisionit nuk është kryer verifikim i thelluar në lidhje me konkluzionet e raportit të DSIK-së. Raporti ka mospërputhje në pjesët e tij, pasi ndërkohë që thuhet se: 'gjatë periudhës në të cilën znj. Klodiana Gjyzari ushtronte detyrën si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, disponohen të dhëna përpara dhe pas periudhës së rivlerësimit kalimtar ku ngrihen dyshime për përfshirjen në veprimtari korruptive', informacioni i dhënë në raport i përket viteve 2005 - 2008. Nuk ka asnjë të dhënë pas vitit 2008. Ndërkohë që ligji nr. 84/2016 ka hyrë në fuqi në vitin 2016. Nga dhjetori i vitit 2014 jam emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë, pra pas hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk kam qenë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Për pasojë nuk mund të ketë informacion pas periudhës së rivlerësimit për veprimtari korruptive të subjektit të rivlerësimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndërkohë që subjekti nuk ka punuar pas periudhës së rivlerësimit, pra pas vitit 2016 në atë gjykatë.

Gjithashtu, kontrolli i figurës, në rastin konkret, është kryer në shkelje të nenit 38/1/2 të ligjit nr. 84/2016, pasi raporti nuk citon prova të sakta, në informacione konfidenciale, si dhe informacione të tjera të disponueshme. Kontrolli i figurës nuk është zhvilluar në mënyrë objektive dhe pa ndikime të karakterit personal.

Citohet raportin: 'Në disa të dhëna të vitit 2008 ka pasur dyshime se gjyqtarja K. Gjyzari mund të ketë përfituar një sasi parash për të favorizuar shtetasin për të cilin ka pasur një çështje penale në ngarkim të tij'. Nga provat që më janë vendosur në dispozicion nga Komisioni konstatohet se nuk është hetuar në lidhje me këtë konstatimin të DSIK-së. Në përgjithësi, për asnjë konstatim të DSIK-së, Komisioni në rastin tim nuk ka kryer verifikim të tyre, por i ka marrë të mirëqena, duke i ngarkuar barrën e provës subjektit. Komisioni më ka ngarkuar me barrë prove për t'u mbrojtur, duke dhënë kundërshtime në lidhje me këtë konstatim, por në mungesë të emrit të të pandehurit konkret, të cilin paskam ndihmuar në vitin 2008, më është bërë e pamundur mbrojtja.

Në lidhje me dy vendimet që citohen në materialin e DSIK-së, të cilat janë të vitit 2005, kam mundësi të jap shpjegime, por në lidhje me shpifjen e kryer, në lidhje me çështjen penale të gjykuar prej meje në vitin 2008, nuk më jepet mundësia të mbrohem, pasi nuk e di kush është minimalisht personi që kam gjykuar që të gjej vendimin përkatës dhe qëndrimet e gjykatave më të larta në lidhje me këtë vendim.

Komisioni duhet të kishte kryer verifikim të rastit të pretenduar, duke qenë se është në dijeni të emrit të të pandehurit përkatës, emër të cilin unë nuk e di. Në vitin 2008 kam qenë në kolegjin penal dhe kam gjykuar më shumë se 200 të pandehur.

Konstatohet se nga Komisioni janë kryer verifikime në të gjitha prokuroritë dhe nuk ka rezultuar që si në vitin 2008, ashtu edhe në ndonjë vit tjetër gjatë ushtrimit të detyrës, të ketë procedim penal ndaj subjektit të rivlerësimit për veprën penale 'korrupsioni pasiv'. Për pasojë, në këtë pjesë raporti mbështetet në thashetheme, jo në prova të sakta apo konfidenciale, apo në informacione të tjera të disponueshme, siç parashikon neni 38/1/2 i ligjit nr. 84/2016. Nuk rezulton që ky informacion t'i jetë përcjellë organeve të hetimit në vitin 2008, në mënyrë që të vërtetohej themelshmëria e tij.

Në lidhje me konkluzionin se: 'Për shtetasen K. Gjyzari disponohen të dhëna ku ngrihen dyshime për përfshirjen në ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj sistemit të drejtësisë në Vlorë, me qëllim favorizimin e procesit civil/çështje pronësie ndaj bashkëshortit të saj, shtetasit E. Gj', deklarohet se ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, shtetasi G. (E.) Gj., nuk ka pasur asnjë gjykim civil, çështje pronësie në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në lidhje me këtë fakt, bashkë me kërkesën për riçelje të hetimit administrativ, kam paraqitur elektronikisht vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pra, edhe në këtë rast nga ana e DSIK-së nuk është verifikuar informacioni i marrë.

Për sa i përket konstatimit se: 'Gjatë vitit 2006 institucionet verifikuese kanë siguruar të dhëna për dyshime dhe marrëdhënie korruptive dhe përfitime të paligjshme në sistemin e drejtësisë pranë gjyqësorit Vlorë, ku Klodiana Gjyzari dyshohet për bashkëpunim me kryetarin e Gjykatës Vlorë, z. A.M. Gjatë një procesi gjyqësor kryetari i gjykatës ka refuzuar një kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës K. Gjyzari dhe me vendimin nr. ****, datë 3.2.2005, kjo gjyqtare ka pushuar çështjen për falsifikim të vendimit nr. ****, datë 17.7.1997, të KKKP-së Vlorë', raporti mbështetet mbi deklaratimet e një punonjësi të institucioneve ligjzbatuese, i cili ka kryer veprën penale 'moskallëzim krimi'.

Në rastin konkret, në një gjykim civil në vitin 2006 nuk kërkohej përjashtimi i trupit gjykues të kryetari i gjykatës, por gjyqtarit që gjykon çështjen, bazuar në nenin 75 të Kodit të Procedurës Civile në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes civile konkrete. Subjekti që ka deklaruar para punonjësit të institucionit ligjzbatues, se i ka kërkuar kryetarin të gjykatës të më përjashtonte nga një çështje që unë gjykoja, ka kryer veprën penale 'ndikim i paligjshëm', pasi i ka kërkuar kryetarin të gjykatës të ndikonte tek unë, të largohesha nga një çështje për përfitime të tij. Punonjësi i institucionit ligjzbatues është bërë palë me shtetasin që ka ushtruar ndikimin e paligjshëm, nuk ka paraqitur kallëzim penal, siç e ka pasur për detyrë, si punonjës shtetëror. Pra, sipas DSIK-së ka dyshime për marrëdhënie korruptive prej meje, pasi një shtetas kryen veprën penale, përpiket të ndikojë te kryetari i gjykatës për interes të tij dhe punonjësi i shtetit që ka marrë këtë informacion nuk paraqet kallëzim penal ndaj atij që pohon ndikimin e paligjshëm, por sipas tij subjekti i rivlerësimit është i korruptuar. Arsyetimi i DSIK-së është abuziv, në shkelje të detyrës së tij, sipas ligjit, pasi duhet ta kishte përpunuar një informacion të tillë. Duke mos paraqitur kallëzim në kohën e duhur punonjës përkatës i ka dhënë mundësi subjektit që ka ushtruar ndikimin e paligjshëm të mos ndëshkohet sipas Kodit Penal. Në lidhje me dosjen përkatëse nr. **** vendimi, datë 3.2.2005, në asnjë seancë nuk është kërkuar përjashtimi im. Me kërkesën për riçelje të hetimit administrativ datë 5.1.2021 kam paraqitur kopje të procesverbalit të dosjes gjyqësore përkatëse.

*Nga përmbajtja e vendimit dhe akteve të dosjes civile me nr. **** vendimi, datë 3.2.2005, rezulton që është pushuar me kërkesë të palës paditëse dhe vendimi nuk është ankimuar. Vendimi i pushimit të gjykimit bazuar në nenin 300 të Kodit të Procedurës Civile nuk ka asnjë efekt mbi padinë dhe asaj që është kërkuar në gjykatë, pra nuk ka efekte, si mund të ketë marrëdhënie korruptive në lidhje me një vendim pa efekte apo pasoja!*

*Gjithashtu, në lidhje me këtë pretendim të parashtruar në raportin e DSIK-së, nga ana e Komisionit duhet të ishte marrë parasysh hetimi administrativ i kryer prej tij në vendimin nr. ***, datë 3.8.2018, për subjektin A. M., vendim i cili nuk është ankimuar në lidhje me hetimin administrativ për raportin e DSIK-së, pra në lidhje me këtë pjesë konsiderohet i formës së prerë.*

*Në këtë vendim është arsyetuar se: 'Trupi gjykses i përbërë nga: K. Gj. - gjyqtare, me vendimin e saj nr. ***, datë 3.2.2005, me palë: paditës: E. K., ...etj., i paditur: Xh. S., M. M., personi i tretë: shoqëria '***', me administrator z. L. Ll., e përfaqësuar nga av. E. V. Objekti: goditje për falsitet i vendimit nr. ***, datë 17.7.1997, të KKK Pronave, Vlorë. Pavlefshmëri e kontratës së shitjes nr. *** rep., datë 22.11.2000. Detyrim i ZVRPP-së Vlorë për çregjistrim nga regjistrat hipotekor. Marrja e masës së përkohshme për sigurimin e padisë. Baza ligjore: nenet 270, 220/a, 205/b, 31 e vijues dhe 153 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur: Pushimin e gjykimit të çështjes civile nr. ***. Nga verifikimi i kësaj dosjeje gjyqësore konstatohet se në seancën e datës 3.2.2005 paditësit kanë kërkuar pezullimin e gjykimit, kërkesë e cila nuk është pranuar nga gjykata dhe se po në këtë seancë kanë kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes civile. Për sa më sipër, bazuar në nenin 201 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se është në disponimin e paditësve vazhdimi i gjykimit ose jo dhe se ata kanë të drejtë të pushojnë gjykimin në çdo fazë, gjykata ka çmuar se gjykimi i kësaj çështjeje duhet të pushohet. Në këtë dosje, konstatohet edhe një biletë shorti me nr. ***, e datës 9.10.2013, e cila ka mbishkrimin me shkrim të lirë dore 'Klodi'. Gjithashtu, në kërkesëpadinë e administruar në dosje, me nr. ***, datë 29.9.2003, konstatohet siglimi me shkrim të lirë dore që mban datën 9.10.2003, në emër të znj. K. Gjyzari. Komisioni vlerëson se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, 'Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', kjo indicie nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit, z. A. M. Gjithashtu, nga analiza e kësaj dosjeje gjyqësore, arrijmë në përfundimin se nuk rezulton i saktë e i bazuar në prova dhe fakte informacioni i ardhur nga institucionet verifikuese, i cituar në 'raportin e pastërtisë së figurës', për subjektin e rivlerësimit, z. A. M.*

*Në lidhje me: 'Sipas informacioneve ekzistojë dyshime serioze e të arsyeshme të shpërdorimit të detyrës nga gjyqtarja K. Gjyzari në dhënien e vendimit civil nr. ****, datë 23.9.2005...', nuk rezulton të jetë paraqitur kallëzim penal në lidhje me këtë vendim, i cili rezulton të jetë i formës së prerë, i paankimuar nga palët. Kryerja e veprës penale 'shpërdorim detyre nuk është në fushën e aktivitetit të DSIK-së.*

*Gjithashtu, në lidhje me këtë pretendim të parashtruar në raportin e DSIK-së, nga ana e Komisionit duhet të ishte marrë parasysh hetimi administrative i kryer prej tij në vendimin nr. ****, datë 3.8.2018, për subjektin A. M., vendim i cili nuk është ankimuar në lidhje me hetimin administrativ për raportin e DSIK-së, për pasojë, në lidhje me këtë pjesë është vendim i formës së prerë. 'Nga analiza e përmbledhur e kësaj dosjeje gjyqësore konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka gjykuar padinë e paraqitur në datën 5.9.2005, nga shtetasi S. D. ndaj palës së paditur Bashkia Vlorë, me person të tretë ZVRPP-në Vlorë, me objekt: detyrimin e palës së paditur të njohë pronësinë e paditësit mbi një shtëpi banimi e truall të ndodhur në lagjen '***', rr. '***', Vlorë, pretenduar e ndërtuar prej tij në vitin 1984 dhe regjistrimin e kësaj pasurie në regjistrat e ZVRPP-së Vlorë. Kjo dosje gjyqësore është marrë në analizë nga ana e Komisionit në pjesën e vlerësimit të pasurisë dhe u konstatua se çështja është gjykuar nga gjyqtarja K. Gj., është hedhur me short dhe është regjistruar në regjistrin elektronik dhe librin e shortit. Gjithashtu është konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe asnjë nga familjarët e tij nuk kanë qenë palë apo përfaqësues në procesin gjyqësor për përfitimin e pronësisë së kësaj banese dhe truallit mbi të cilin ajo është ndërtuar. Gjithashtu, nga analiza e kësaj dosjeje gjyqësore arrijmë në përfundimin se nuk rezulton i saktë e i bazuar në prova dhe fakte informacioni i ardhur nga institucionet verifikuese, i cituar në 'raportin e pastërtisë së figurës' për subjektin e rivlerësimit, z. A. M. Në lidhje me: 'Informacion me indicie për veprimtari të kundërligjshme në sistemin e drejtësisë në Vlorë për shtetasin E. Gj (ish-bashkëshorti i subjektit), si i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme në formën e ndikimit ndaj një*

gjqytari në Vlorë me qëllim favorizimin e një shtetasi kundrejt përfitimeve të paligjshme'. Ky informacion në asnjë fjalë nuk ka lidhje me subjektin e rivlerësimit. Edhe në rast se ka pasur ndikim të paligjshëm nga ana e ish-bashkëshortit, nuk ka pasur lidhje me detyrën e ushtruar prej meje apo një gjyqtari i cili ushtron detyrën në një gjykatë nën kompetencën territoriale të Gjykatës së Apelit Vlorë, ku unë ushtroj funksionin. Gjykata e Apelit ku unë ushtroj funksionin nuk ka kompetencë mbi vendimet e gjykatës administrative të shkallës së parë Vlorë. Por nga verifikimet e kryera nga ana e Komisionit nuk rezultojn procedim penal i regjistruar, i filluar a i mosfilluar, në lidhje me sa parashtrohet për ish-bashkëshortin.

Në tërësinë e tij, informacioni mbështetet në të dhëna të paverifikuara, të dhëna që kanë përbërë veprë penale, në kohën kur janë marrë nga punonjësit përkatës, të cilët jo vetëm nuk i kanë verifikuar për vërtetësinë e tyre, por kanë bashkëpunuar me subjektet që kanë kryer ndikimin e paligjshëm, duke fshehur dhe mbuluar veprimet e tyre dhe të dhëna të cilat nuk kanë të bëjnë me subjektin e rivlerësimit, por me ish-bashkëshortin, me të cilin subjekti ka zgjidhur martesën që prej vitit 2013 dhe nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi. Edhe në rast se nuk do të isha e divorcuar, duhet të vërtetohej lidhja e thashethemit me mua, ushtrimin e detyrës prej meje, si dhe të verifikohet bazueshmëria e tij. Në rastin konkret nuk vërtetohet asnjë rrethanë që ky thashethem të ketë lidhje me mua si subjekt i rivlerësimit.

Në konkluzion: Raporti i DSIK-së nuk mbështetet në nenin 38/4 të ligjit nr. 84/2016; subjekti i rivlerësimit nuk ka asnjë kontakt të papërshtatshëm, në kuptim të këtij neni, për pasojë bazuar në nenin 37/2 të ligjit nr. 84/2016 konkluzioni se subjekti ka tendencë kriminale për përfshirjen në krimin e organizuar nuk ka mbështetje në ndonjë informacion konkret apo provë, gjithashtu edhe vlerësimi i përgjithshëm, sipas nenit 37/c të ligjit, se individit mund të vihet nën presion nga struktura kriminale, nuk ka mbështetje, pasi të vetmet të dhëna që ka DSIK-ja janë të para më shumë se 10 viteve, janë të pambështetura, të pavërteta, abuzive dhe një pjesë e tyre nuk kanë lidhje me subjektin e rivlerësimit, por me ish-bashkëshortin, me të cilin kam zgjidhur martesën shumë vjet më parë.

Për sa më sipër, kërkoj të mos merret parasysh raporti i DSIK-së si raport i pabazuar në ligj dhe në prova dhe të vlerësohem e përshtatshme për vazhdimin e detyrës”.

Trupi gjykues, nën të gjitha argumentet e parashtuara dhe të arsyetuara më sipër në lidhje me kontrollin e figurës, arrin në konkluzion se përgjatë hetimit administrativ nuk rezultoi i provuar ndonjë informacion që ndikonte në pozitën e subjektit me qëllim penalizimin e saj për vijimin e ushtrimit të detyrës dhe konkludon mbi provueshmërinë e përshtatshmërisë së subjektit për vijimin e ushtrimit të detyrës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Vlerësimi profesional, për subjektin Klodiana Gjyzari në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Apelit Vlorë, është përgatitur duke analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit për aftësitë profesionale, organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, si dhe aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Vlerësimi është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dokumente ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

1. Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotë sipas shtojcës të ligjit.

b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Sipas formularit të vetëdeklarimit, gjyqtarja Klodiana Gjyzari, në periudhën tetor 2001– dhjetor 2014, ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në periudhën dhjetor 2014 dhe aktualisht ushtron funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Vlorë.

c) Detyrat e kryera tre vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, ka deklaruar se tre vitet e fundit ka punuar në fushën e të drejtës civile, penale dhe familjare. Subjekti nuk është specializuar në ndonjë fushë të së drejtës.

Subjekti i rivlerësimit në funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykatës së Apelit Vlorë ka deklaruar këto të dhëna: numri i çështjeve të caktuar për gjykim në tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës ka qenë 1624 çështje; numri i çështjeve të përfunduara në tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës ka qenë 1512 çështje; dhe numri i çështjeve të mbartura vitin e fundit të ushtrimit të detyrës ka qenë 18 çështje.

Këto të dhëna përputhen me të dhënat e tabelave statistikore të kryesekretarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. *****, datë 19.1.2017 dhe të Gjykatës së Apelit Vlorë nr. *****, datë 23.1.2017.

ç) Trajnimet në tre vitet e fundit

Subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, ka paraqitur vërtetim nr. *****, datë 20.10.2016, në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës gjatë periudhës 8.10. 2013 – 8.10.2016, në trajnimin në disa tema.

i. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, ka paraqitur tri dokumente ligjore të llojit vendime gjyqësore të cilat i përkasin viteve 2014, 2015 dhe 2016, të cilat numërtohen: dokumenti nr. 1, dokumenti nr. 2 dhe dokumenti nr. 3.

Dokument nr. 1

Vendimi nr. *****, datë 6.5.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që i përket paditëses I. M. kundër të paditurve sh.p.k. “*****”, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Bashkia Vlorë, L. P., etj. , me objekt *“kallëzimin e një punimi të ri”*.

Dokument nr. 2

Vendimi nr. ***, datë 24.2.2015, i Gjykatës së Apelit Vlorë, që i përket kërkuesit V. P. me objekt *“rivendosje në afat ankimi ndaj vendimi penal”*, me palë të interesuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Dokument nr. 3

Vendimi nr. ***, datë 2.3.2016, i Gjykatës së Apelit Vlorë, me paditës A. H. dhe B. H. kundër të paditurit shoqëria përmbarimore “*****” sh.p.k dhe “Raiffeisen Bank”, me objekt *“kundërshtim të veprimeve përmbarimore”*.

2. Gjetjet nga vëzhgimi i pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv

Dosja nr. 1. Çështja civile nr. *** regj. them., datë 27.5.2013 regjistrimi, që i përket paditësit J. K. kundër të paditurit Drejtoria ALUIZNI Vlorë, Zyra Vendore e Rr. P. Paluajtshme Vlorë, S. N. Etj., me objekt *“anulimin e procedurave të legalizimit në favor të paditurit S. N.”*, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 22.11.2013.

Me vendimin e datës 30.5.2013 (2 dite më pas nga caktimi i çështjes) gjyqtarja Klodiana Gjyzari ka caktuar seancën përgatitore në datën 25.6.2013, ora 10:00, duke respektuar afatin 10 ditor të përcaktuar në nenin 155 të Kodit të Procedurës Civile.

Në datën 22.11.2013, pasi është deklaruar i mbyllur hetimi dhe shqyrtimi i çështjes, gjykata ka vendosur “*rrëzimin e kërkesë padisë*”.

Kundër vendimit kanë ushtruar ankim i padituri S. N. dhe Gjykata e Apelit Vlorë me vendim nr. ***, datë 26.4.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimi dhe pranimin e padisë.

Arsyet e cenimit të vendimit: vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i pabazuar në prova dhe në ligj, pasi është interpretuar gabim ligji procedural civil (nenet 31, 32 dhe 213 e vijues i Kodit të Procedurës Civile) që lidhen me shkakun e ngritjes së padisë dhe interesin e ligjshëm në ngritjen e saj, si dhe marrjen dhe vlerësimin e provave.

Ndaj vendimit është shtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, ku dhe aktualisht ndodhet fashikulli civil i pashqyrtuar.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit në sekretarinë gjyqësore brenda afatit 10 ditor të përcaktuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes ka zgjatur 5 muaj e 25 ditë, në intervalin kohor 27.5.2013 – 22.11.2013, brenda afatit 6 muajor të parashikuar nga pika 5, germa “e”, e Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit¹³ dhe, rrjedhimisht, është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor i përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Janë caktuar 12 seanca (4 përgatitore dhe 8 gjyqësore) nga të cilat 5 produktive dhe 7 joproduktive (*shihni seanca nr. 1,2,3 7, 8, 9 dhe 11*). Shkaku i dështimit të tyre ka qenë i justifikuar. Ka pasur një rast ku seanca është çelur 30 minuta para orarit por nuk ka sjellë pasojë për gjykimin. Distanca kohore midis seancave mesatarisht kanë qenë të arsyeshme me rreth 15 ditë nga njëra tjetra duke përfshirë 1 rast me mbi 2 muaj për shkak të pushimeve vjetore të muajit gusht (*shihni seancën nr. 3*). Seancat gjyqësore nuk janë zhvilluar në sallë gjykimi me regjistrim audio, në funksion të transparencës dhe të solemnitetit dhe nuk raportohet shkaku.

Vendimi gjyqësor përfundimtarë është i strukturuar sipas elementëve të parashikuar në nenin 310 të Kodit të Procedurës Civile.

Dosja nr. 2. Çështja penale nr. **** regjistri, datë 30.1.2014 regjistrimi, që i përket kërkuesit Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i pandehur A. GJ., akuzuar për kryerjen e veprës penale “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe “mosbindjes ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 19.3.2014.

Çështja është regjistruar në gjykatë dhe me shortin e datës 30.1.2014, i është caktuar gjyqtarës Klodiana Gjyzari dhe brenda 8 ditëve gjyqtarja ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore më 28.2.2014, ora 10:00, duke urdhëruar njoftimin e palëve, të prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit. Data e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatet 10 ditore të përcaktuara në nenin 333 të Kodit të Procedurës Civile.

Në datën 19.3.2014 është deklaruar i mbyllur shqyrtimi gjyqësor dhe gjykata tërhiqet për vendim dhe në kthim ka shpallur vendimin nr. ***, datë 19.3.2014, në të cilin është vendosur: deklarin fajtor të pandehurit A. GJ., për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 291 e 51 të Kodit Penal dhe dënimin me 3 muaj burgim, deklarin fajtor të pandehurit sipas nenit 242 e 51 të Kodit Penal dhe dënimin me 1 muaj burgim, sipas nenit 55 të Kodit Penal në bashkim të dy dënimeve e dënon me 3 muaj burgim dhe në aplikim edhe të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dhe 59 të Kodit Penal dënimin e tij me 2 muaj burgim me kusht pezullues për 3 vjet.

Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim dhe ka marrë formë të prerë në datën 31.3.2014.

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar në sekretari brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Gjykimi i çështjes ka zgjatur gjithsej 1 muaj e 20 ditë në intervalin kohor 30.1.2014 – 19.3.2014. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard 9-mujor të përcaktuar nga germa “a”, pika 5, e Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit¹⁴. Rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Vendimi gjyqësor përfundimtar është i strukturuar sipas elementëve të parashikuar në nenin 383 të Kodit të Procedurës Penale.

Dosja nr. 3. Çështja penale nr. *** regj. them., datë 16.2.2015 regjistrimi, kundër të pandehurit M. D., të akuzuar për veprën penale “*vjedhje e energjisë elektrike dhe impulseve telefonike*” të parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 29.9.2015.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit Vlorë në datën 16.2.2015 dhe me shortin e datës 16.2.2015 i është caktuar gjyqtarja Klodiana Gjyzari. Me vendimin e datës 13.9.2015, gjyqtarja Klodiana Gjyzari vendos për kalimin në seancë gjyqësore në datën 29.9.2015, ora 11:15 (pas 6 muaj e 27 ditëve). Kryetari Kolegjit të Apelit cakton relatorin e çështjes dhe ditën e gjykimit sipas nenit 426/1 të Kodit të Procedurës Penale, ku afati i paraqitjes nuk mund të jetë më i vogël se 10 ditë nga data e njoftimit.

Seanca gjyqësore e datës 29.9.2015, është çelur në orën 11:38, me 23 minuta vonesë dhe nuk citohet shkaku dhe është dokumentuar me procesverbal dhe regjistrim audio në sallën nr. **. Gjykata është tërhequr për vendim dhe në kthim ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 16.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit në datën 15.10.2015 – pas 16 ditëve, jashtë afatit 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 të Kodit të Procedurës Penale.

Nga analiza e të dhënave të nxjerra nga vëzhgimi i kësaj çështjeje, konstatohet se gjykimi nga subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, ka zgjatur gjithsej 7 muaj e 13 ditë, në intervalin kohor 16.2.2015 – 29.9.2015, nga data e regjistrimit. Kjo kohëzgjatje nuk është në përputhje me standardin kohor 6-mujor të vendosur nga KLD-ja me vendimin nr. ***, datë 14.4.2010, si dhe germa “g”, pika 5, e Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, “Për kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore” .

Janë kryer veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor dhe janë dokumentuar rregullisht. Është caktuar 1 seancë gjyqësore e cila ka qenë produktive. Ka vonesë 23 minuta në fillimin e seancës, shkaku nuk relatohet, por nuk ka sjellë pasoja për gjykimin. Seanca është zhvilluar në sallë dhe është regjistruar.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk ka të meta. Nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes sipas nenit 464 të Kodit të Procedurës Civile.

Vendimi gjyqësor përfundimtar është i strukturuar sipas elementëve të parashikuar në nenin 383 të Kodit të Procedurës Penale.

Për sa i përket shkrimit ligjor, rezulton se janë respektuar rregullat drejtshkrimore të gjuhës zyrtare shqipe në ndërtimin e fjalëve dhe fjalive dhe në tërësi përdoren rregullisht karakteret e gjuhës shqipe. Në dosje e cila është fotokopje nuk ndodhet dorëshkrim i vendimit sipas nenit

382 të Kodit të Procedurës Penale, por një kopje vendim i zbardhur nga sekretaria gjyqësore 6 faqe i nënshkruar nga të tre gjyqtarët. Vendimi është i kuptueshëm dhe i argumentuar.

Dosja nr. 4. Çështja penale nr. *** regj. them., datë 4.3.2015, regjistrimi, kundër të pandehurve T. R., B. D., S. F., të akuzuar për veprën penale “*vjedhje duke shpërdoruar detyrën*” të parashikuar nga nenet 135 e 25 të Kodit Penal, kundër të pandehurve Q. T. dhe XH. H., të akuzuar për veprën penale “*vjedhje*”, të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, kundër të pandehurve SH. T., R. G., J. H., N. H. dhe K. L. të akuzuar për veprën penale “*vjedhje*”, të mbetur në tentativë të parashikuar nga neni 134/2 dhe 22 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 16.9.2015.

Çështja është regjistruar në datën 4.3.2015 në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe me shortin e datës 4.3.2015 i është caktuar gjyqtarës Klodiana Gjyzari. Nuk ka vendimin formal nga gjyqtarja Klodiana Gjyzari për kalimin në seancë gjyqësore të çështjes (*Kryetari Kolegjit të Apelit cakton relatorin e çështjes dhe ditën e gjykimit sipas nenit 426/1 të Kodit të Procedurës Penale duke siguruar një afat jo më të vogël se 10 ditë për paraqitjen e palëve*).

Në datën 16.9.2015, gjykata është tërhequr për vendim dhe në kthim ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 23.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Seanca gjyqësore është mbyllur në orën 13:22 minuta.

Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit në datën 13.10.2015 – pas 27 ditëve, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Nga analiza e të dhënave të nxjerra nga vëzhgimi i kësaj çështjeje, konstatohet se gjykimi nga subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, ka zgjatur gjithsej 5 muaj e 12 ditë, në intervalin kohor 4.3.2015 – 16.9.2015, nga data e regjistrimit, brenda afatit kohor 6-mujor .

Janë kryer veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor dhe janë dokumentuar rregullisht. Nuk ka vendimin formal nga gjyqtarja Klodiana Gjyzari për kalimin në seancë gjyqësore të çështjes sipas nenit 426/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe nuk ka relativitet me shkrim nga gjyqtarja relatorë e çështjes. Janë caktuar 5 seanca gjyqësore, 1 seancë ka qenë produktive dhe 4 seanca joproduktive, por shkaqet kanë qenë të justifikuar (shihni seancat nr. 1,2,3, dhe 4). Ka vonesë në fillimin e 4 seancave gjyqësore nga 12 deri në 23 minuta. Shkaqet e vonesës nuk relatohen (shihni seancat nr. 2,3,4 dhe 5). Dy seanca janë caktuar jashtë afatit 15 ditorë, përcaktuar nga neni 342/2 i Kodit të Procedurës Penale (shihni seancat nr. 2 dhe 4).

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk është i plotë. Aty gjendet akti i shorti për caktimin e gjyqtarit relator, nuk ka vendim formal për kalimin në seancë gjyqësore, aktet e njoftimit, ankimi i prokurorit, vendimi gjyqësor, fleta e regjistrimit të dorëzimit të vendimit në sekretari dhe fleta inventarit të dosjes. Nuk ka relativitet me shkrim nga gjyqtarja relatorë.

Vendimi gjyqësor përfundimtar është i strukturuar sipas elementëve të parashikuar në nenin 383 të Kodit të Procedurës Penale.

Në dosje e cila është fotokopje nuk ndodhet dorëshkrim i vendimit sipas nenit 382 të Kodit të Procedurës Penale, por një kopje vendim i zbardhur nga sekretaria gjyqësore 18 faqe i nënshkruar nga të tre gjyqtarët. Vendimi është i kuptueshëm dhe i argumentuar.

Dosja 5. Çështja civile . **** regj. them., datë 23.6.2015 regjistrimi, që i përket paditës A. S. kundër të paditurit OSHEE, Njësia Vlorë, me objekt “*detyrimin e palës paditur për lidhjen e kontratës për furnizimin me energji elektrike*”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 10.3.2016.

Çështja është regjistruar në datën 23.6.2015 në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe me shortin e datës 24.6.2015, i është caktuar gjyqtarës relatore Klodiana Gjyzari. Me vendimin e datës nuk ka akt nga gjyqtarja Klodiana Gjyzari për kalimin në seancë gjyqësore (*Kryetari Gjykatës së Apelit cakton relatorin e çështjes dhe ditën e gjykimit sipas nenit 460/2 të Kodit të Procedurës Civile*). Në dosje nuk ka akte që tregojnë kalimin e çështjes dhe njoftimin e palëve për caktimin e seancës së parë gjyqësorë nga subjekti i rivlerësimit apo kryetari i gjykatës.

Seanca e datës 10.3.2016 është çelur në orën 11:38 dhe është dokumentuar me procesverbal e regjistrim audio në sallën nr. **. Gjykata me vendim ka mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe është tërhequr për vendim dhe në kthim ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit gjyqësor civil nr.***, datë 12.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në dispozitiv nuk disponohet për shpenzimet gjyqësore dhe nuk tregohet e drejta dhe afati i rekursit sipas nenit 476 të Kodit të Procedurës Civile.

Ndaj vendimit nuk është ushtruar rekurs.

Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit në datën 29.03.2016 – pas 19 ditëve, jashtë afatit 10 ditor ligjor të përcaktuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Nga analiza e të dhënave të nxjerra nga vëzhgimi i kësaj çështjeje, konstatohet se gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 8 muaj e 15 ditë, në intervalin kohor 23.6.2015 – 10.3.2016, nga data e shortit. Kjo kohëzgjatje nuk është në përputhje me standardin kohor 6-mujor të vendosur me vendimin nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së, pika 5, germa "h", të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, "Për kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore", por justifikohet pasi data e seancës së parë caktohet nga kryetari i gjykatës sipas nenit 460/2 të Kodit të Procedurës Civile.

Janë kryer veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, por nuk janë dokumentuar rregullisht.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk është i plotë. Akte për caktimin e seancës parë gjyqësore dhe për njoftimin e palëve/kopje të listës së gjykimeve nuk ka në dosje. Vendimet e ndërmjetme nuk kanë cituar bazën ligjore. Nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes sipas nenit 464 të Kodit të Procedurës Civile.

Vendimi gjyqësor është i strukturuar sipas elementëve të parashikuar në nenin 310 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese.

Për sa i përket shkrimit ligjor, rezulton se janë respektuar rregullat drejtshkrimore të gjuhës zyrtare shqipe në ndërtimin e fjalëve dhe fjalive, por nuk përdoren rregullisht karakteret e gjuhës shqipe. Në dosje e cila është fotokopje nuk ndodhet dorëshkrim i vendimit nga gjyqtarja relatore, por një kopje vendimi i zbardhur nga sekretaria gjyqësore 7 faqe i nënshkruar nga të tre gjyqtarët. Vendimi është i kuptueshëm dhe i argumentuar.

Rivlerësimi i bërë nga Komisioni

Gjyqtarja Klodiana Gjyzari në tri dokumentet ligjore të prezantuara prej saj dhe në pesë dosjet e përzgjedhura me short tregon se ka aftësi mesatare në arsyetimin ligjor të vendimeve civile dhe penale. Gjyqtarja në një rast ka interpretuar gabim ligjin procedural civil - nenet 3, 32 dhe 213 e vijues të Kodit të Procedurës Civile mbi shkakun dhe interesin e ligjshëm për ngritjen e padisë dhe vlerësimin e provave (shihni dosjen nr. 1), duke sjellë si pasojë cenimin e vendimit nga gjykatat më të larta.

Gjithashtu, pjesë e arsytimit gjyqësor është edhe dispozitivi i vendimit ku në të gjitha rastet disponohet për kërkimet kryesore rreth akuzës penale apo objektit të padisë civile, por në dispozitivin e tij shpesh mungon disponimi për shpenzimet gjyqësore dhe e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit apo rekursit në një gjykatë më të lartë (shihni dokumentet 2, 3 dhe dosjet 3, 4 dhe 5).

Gjyqtarja në vendimet e hartuara prej saj në përgjithësi nuk ka përdorur parimet e së drejtës me përjashtim të: parimit të sigurisë juridike (shihni dokumentin nr. 2), parimin e oralitetit – verbalitetit (shihni dosjen nr. 1).

Në interpretim të germës “g”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë i dhomës penale dhe civile (që nuk është i organizuar në seksione) duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh (krime dhe kv/penale dhe civile me mosmarrëveshje me palë kundërshtare). Duke zbatuar këtë rregull, në rastin e gjyqtarës Klodiana Gjyzari, konstatohet se ka gjykuar 210 çështje sipas standardit në periudhën 14-mujore 8.10.2013 – 19.12.2014, duke pasur një ngarkesë sasiore të standardit minimal.

Për sa i përket aspektit kohor, nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Klodiana Gjyzari ka qenë në intervale kohore nga 1 muaj e 20 ditë (shihni dosjen nr. 2), deri në 8 muaj e 15 ditë (shihni dosjen nr. 5). Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 5 muaj e 25 ditë (shihni dosjen nr. 1), 7 muaj 13 ditë ditë (shihni dosjen nr. 3) dhe 5 muaj e 12 ditë (shihni dosjen nr. 4). Mesatarja e përfundimit të gjykimit të 5 dosjeve është 5 muaj e 23 ditë për çështje.

Në interpretim të germave “a” dhe “e”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve të përcaktuar me vendimit nr. ***, datë 14.4.2010, “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, të KLD-së, në aspektin kohor, gjykimet e çështjeve penale të themelit në gjykatën e shkallës së parë duhet të gjykohen jo më tej se 4 muaj (kv. penale) dhe 9 – 12 muaj (krime), ndërsa civilët e përgjithshme jo më tej se 6 muaj. Në interpretim të germave “g” dhe “h”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve të përcaktuar me vendimin nr. ***, datë 14.4.2010, “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, të KLD-së, në aspektin kohor, gjykimet e çështjeve penale në gjykatën e apelit duhet të gjykohen jo më tej se 2 muaj (kv. penale) dhe 6 – 9 muaj (krime), ndërsa çështjet civile jo më tej se 6 muaj. Nga të dhënat e mësipërme rezulton se afati kohor i gjykimit ka dalë jashtë afatit 6-mujor në 2 raste (*shihni dosjet nr. 3 dhe nr. 5*), nga të cilat 1 rast është i justifikuar pasi çështja civile në gjykatën e apelit vihet në lëvizje nga kryetari i gjykatës sipas nenit 460/2 të Kodit të Procedurës Civile (*shihni dosjen nr. 5*). Në këtë kuptim koha e gjykimit respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 6 të KEDNj-së.

Ndërsa nga analiza e tri dokumenteve ligjore të prezantuara nga subjekti i rivlerësimit rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Klodiana Gjyzari ka qenë në intervale kohore nga 6 muaj e 4 ditë (shihni çështje civile - dokumenti nr. 1) tej afatit 6-mujor të përcaktuar me vendim të KLD-së. Në dokumentet e tjerë kohëzgjatja e gjykimit nuk mund të përcaktohet pasi nuk ka të dhëna mbi datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë (shihni dokumentin nr. 2 dhe nr. 3).

Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsytimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara (2 civile dhe 3 penale) është konstatuar se gjyqtarja Klodiana Gjyzari nuk i ka kushtuar rëndësi arsytimit në kohë të vendimeve gjyqësore. Vendimi është arsyetuar për 10 ditë (shihni dosjen nr. 1), për 5 ditë (shihni dosjen nr. 2), për 16 ditë (shihni dosjen nr. 3), për 27 ditë (shihni dosjen nr. 4), për 19 ditë (shihni dosja nr. 5).

Për rrjedhim, në tri raste arsyetimi rezulton tej afatit ligjor (shihni dosjet nr. 3, 4 dhe 5). Ndërsa koha mesatare e arsyetimit të 2 vendimeve gjyqësore civile nga gjyqtarja Klodiana Gjyzari rezulton 14.5 ditë (shihni dosjen nr. 1 dhe 5), jashtë afatit ligjor 10 ditor të përcaktuar nga neni 310/2 i Kodit të Procedurës Civile, ndërsa koha mesatare e arsyetimit të 3 vendimeve gjyqësore penale nga gjyqtarja Klodiana Gjyzari rezulton 16 ditë (shihni dosjet nr. 2, 3 dhe 4), jashtë afatit ligjor 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Në këtë aspekt për të dyja rastet duhet cituar edhe fakti që nuk është tejkaluar afati ligjor 15 ditor i ankimit në gjykatën e apelit dhe afati 30 ditor i rekursit në gjykatën e lartë.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, ka kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim përfundimin në kohë të gjykimit të çështjeve. Pas marrjes së çështjes me short ka vënë në lëvizje çështjen shpejt përmes vendimeve formale për caktimin e seancës gjyqësore dhe njoftimin e palëve sipas afateve procedurale. Ndër 5 çështjet e vëzhguara, është konstatuar se në 1 rast çështja është vënë në lëvizje tej afatit 10 ditor të përcaktuar nga neni 333 lidhur me nenin 426/1 të Kodit të Procedurës Penale për gjykimet në apel (shihni dosjen nr. 3), në 1 rast nuk ka vendim formal për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore sipas nenit 426/1 të Kodit të Procedurës Penale për gjykimet në apel dhe as akte për njoftimin e palëve (shihni dosjen nr. 4). Nga verifikimi i 5 dosjeve gjyqësore rezulton se 2 prej tyre kanë përfunduar me 1 seancë (shihni dosjet nr. 3 dhe nr. 5), 1 çështje me 3 seanca (shihni dosjen nr. 2), 1 çështje me 5 seanca (shihni dosjen nr. 4) dhe 1 çështje me 13 seanca (shihni dosjen nr. 1). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 23 seanca të zhvilluara prej saj, mesatarisht 4.5 seanca për çdo çështje, 11 prej këtyre seancave kanë qenë produktive, ndërsa 12 seanca ose rreth 50 % e tyre kanë qenë joproduktive. Pengesat që kanë çuar në dështimin e tyre kanë qenë të justifikuara për shkaqe procedurale (shihni dosjet nr. 1 dhe nr. 2). Seancat gjyqësore penale janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe me regjistrim audio, në funksion të solemnitetit dhe të transparencës së gjykimit (shihni dosjet 3, 4 dhe 5) dhe seancat civile në 2 raste pa regjistrim audio dhe nuk relatohet shkaku (shihni dosjet 1 dhe 2).

Në çeljen e seancave nuk ka pasur 5 vonesa nga 12 deri në 23 minuta. Shkaqet e vonesës nuk janë relatuar, por vonesa nuk ka sjellë pasoja për gjykimin e çështjes (shihni dosjet 3 dhe 4) ndërsa në 1 rast seanca ka filluar 30 minuta para orarit të caktuar, por nuk ka sjellë pasojë për gjykimin (shihni dosjen nr. 1). Gjatë gjykimit, gjyqtarja identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara për realizimin e tyre. Përgjithësisht, zhvillon siç duhet procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor me vendime të ndërmjetme, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, prezantimin e gjykatës, shqyrtimin e kërtimeve paraprake, debatin dhe shqyrtimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve, deri në shpalljen e vendimit. Ka raste kur në proces verbalet e verifikuara të seancave gjyqësore vihen re mungesa të disponimit me vendime të ndërmjetme (shihni dosjen nr. 4) dhe pa cituar bazën ligjore (shihni dosjen nr. 5). Nga tri dosjet e shqyrtuara në gjykatën e apelit gjyqtarja relatore Klodiana Gjyzari nuk ka relatuar me shkrim çështjen objekt gjykimi (shihni dosjet 3, 4 dhe 5).

Në 2 raste mungojnë vendimet e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, si dhe aktet e njoftimit apo listat e shpallura për gjykim (shihni dosjet 4 dhe 5), 3 raste mungon akti për relativimin me shkrim të çështjes (shihni dosjet 3, 4 dhe 5), mungon dorëshkrimi i vendimit përfundimtar (shihni dosjet 3, 4 dhe 5).

Gjyqtarja Klodiana Gjyzari i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Sipas nenit 76/5, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën Shqipërisë”, për vlerësimin “*shumë mirë*” periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 40 ditë në vit dhe jo më shumë se 200 ditë gjatë

pesë vjetëve. Për rrjedhim, duke interpretuar shifrat me rendin zbritës, standardi minimal rezulton 28 ditë për 3 vjet. Të dhënat e Shkollës së Magjistraturës të dokumentuara me vërtetim nr. ***. datë 20.10.2016, provojnë se gjyqtarja për periudhën tre vjeçare të rivlerësimit ka qenë pjesëmarrëse në 14 seminare trajnimi, me 21 ditë trajnim në 3 vjet. Për rrjedhim, subjekti rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, nuk ka plotësuar standardin minimal të pjesëmarrjes në formimin vazhdues prej 28 ditësh në 3 vjet, sipas nenit 76 pika 5 të Ligjit për Statusin.

Lidhur me konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni, si dhe për 5 çështjet e përzgjedhura me short, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit lidhur me kriterin e vlerësimit profesional subjekti parashitroi: *“Në lidhje me konstatimin se në dosjet e gjykimeve në Gjykatën e Apelit, mungojnë listat e gjykimeve, relacioni me shkrim, vlerësoj se është i gabuar. Këto akte nuk vendosen në dosjen gjyqësore dhe nuk ndodhen në asnjë dosje të Gjykatës së Apelit Vlorë. Nuk ka asnjë dispozitë procedural civile apo penale të cilat të parashikojnë se listat e gjykimeve, relacioni me shkrim, të administrohen në dosje. Për sa i përket relacionit, nuk parashikohet në ndonjë dispozitë procedurale forma e tij me shkrim. Gjithashtu, në çdo dosje ndodhet vendimi i nënshkruar në origjinal nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, cili përbën dorëshkrim, apo vendim.*

Për sa i përket mungesës në shënimet e sekretarisë gjyqësore të bazës ligjore të vendimeve të ndërmjetme, është konstatim i gabuar. Procesverbal përbën regjistrimi audio, jo shënimi i sekretares gjyqësore, bazuar në nenin 118 të Kodit të Procedurës Civile dhe 115 të Kodit të Procedurës Penale. Ky konstatim i Komisionit, bazohet në shënimin e sekretares gjyqësore, akt i cili nuk përbën procesverbal të seancës dhe nuk pasqyron tërësisht vendimet dhe deklarimet e palëve. Konstatimi se gjatë gjykimit në apel nuk janë administruar provat, nuk është marrë vendim për provat, por pas dëgjimit të palëve gjykata është tërhequr për vendim, është i gabuar dhe i pabazuar në dispozitat procedurale civile dhe penale që parashikojnë procedurën e gjykimit në apel. Gjykata e Apelit shprehet në lidhje me provat, në rast se ka riçelur hetimin gjyqësor. Në rast se nuk ka riçelur hetimin gjyqësor, siç ka ndodhur në dosjet e vëzhguara, Gjykata e Apelit nuk merr vendim për prova, por pasi dëgjon ankuesin, palët e tjera, tërhiqet për vendim.

Në lidhje me mungesën e disponimit në lidhje me shpenzimet gjyqësore, ato janë pjesë e vendimmarrjes së gjykatës së apelit, në rast se palët kanë ushtruar ankim në lidhje me to, ose në rast të ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Pas ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr. 38/2017, në nenin 465/4 është parashikuar si e drejtë e palëve për të kërkuar edhe shpenzimet gjyqësore në gjykatën e apelit.

Në lidhje me mungesën e përcaktimit në vendim të të drejtës për të ushtruar rekurs, nuk përbën element të vendimit të gjykatës së apelit. Në Kodin e Procedurës Civile është parashikuar në nenin 310 të tij se si element i vendimit është edhe e drejta për të paraqitur ankim dhe afati i tij, por ky është element i vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kjo dispozitë nuk ka efekt për gjykatën e apelit. Në lidhje me rekursin, jo në çdo rast lejohet rekurs, dhe ligji procedural civil në asnjë dispozitë të tij nuk ka parashikuar si element të vendimit të gjykatës së apelit, disponimin për të paraqitur rekurs dhe afatin e tij. Kjo, për shkak se lejimi i të drejtës së rekursit ka të bëjë me përmbajtjen e rekursit, shkaqet për të cilat paraqitet rekurs janë taksativisht të parashikuara në ligj. Nëse një palë apo pjesëmarrës lejohet të paraqesë rekurs varet nga përmbajtja e aktit, rekursit. Gjykata e Apelit mund të shprehet “Kundër këtij vendimi lejohet rekurs sipas rasteve të parashikuara në ligj” dhe një disponim i tillë njëlloj do të ishte i panevojshëm duke qenë se pala përkatëse duhet t`i referohet ligjit.

*Në lidhje me mospërcaktimin e shkakut të moszhvillimit të seancës gjyqësore me sistemin audio në dosjen nr. 1. Çështja civile nr. *** regj. them, datë 27.5.2013 regjistrimi, që i përket paditësit J. K., kundër të paditurit Drejtoria ALUIZNI Vlorë, etj., në periudhën përkatëse nuk punonte sistemi audio në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë, për pasojë asnjë seancë nuk është zhvilluar me këtë sistem. Nga ana e Komisionit duhet të ishin marrë të dhëna në lidhje me fillimin e funksionimit të sistemit audio në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë, para konstatimit.*

Në lidhje me kohën e arsytimit të vendimeve gjyqësore, Komisioni është mbështetur në dispozitat ligjore procedurale që parashikojnë afatet procedurale për shkallën e parë. Konkluzioni se nuk i kam kushtuar rëndësinë e duhur arsytimit të vendimit është i gabuar, pasi mbështetet vetëm në aspektin kohor, por jo në kompleksitetin e çështjes.

*Në lidhje me pjesëmarrjen në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, Komisioni ka përdorur referencën e gabuar ligjore. Neni 76/5, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën Shqipërisë”, nuk ka fuqi prapavepruese dhe nuk ka efekt për periudhën para hyrjes në fuqi të ligjit. Të dhënat e Shkollës së Magjistraturës të dokumentuara me vërtetim nr. ***, datë 20.10.2016, provojnë se gjyqtarja për periudhën trevjeçare të rivlerësimit ka qene pjesëmarrëse në 14 seminare trajnimi, me 21 ditë trajnim në 3 vjet, por kjo periudhë është para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën Shqipërisë”. Në këtë periudhë nuk ka efekt neni 76/5, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën Shqipërisë”, duke qenë se ligji ka efekt pas hyrjes së tij në fuqi”.*

DENONCIMET

Për subjektin e rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, janë paraqitur 27 denoncime në Komision.

Pas vlerësimit të denoncimeve dhe informacionit që disponon Komisioni, u kërkuan praktikant dhe vendimet e dhëna nga subjekti për të cilat rezultuan *indicie*, lidhur me 19 çështje gjyqësore.

Gjykata e Apelit Vlorë me shkresën nr. ***, datë 2.10.2020, si dhe gjykatat përkatëse kanë dërguar informacionin e kërkuar nga Komisioni lidhur me disa vendime gjyqësore. Nga praktika e dërguar rezulton se:

1. Çështja e referuar nga DSIK-ja në raportin e kontrollit të figurës.

Me vendimin nr. ***, datë 23.9.2005, subjekti i rivlerësimit si gjyqtare e vetme, ka vendosur pranimin e kërkesë padisë së z. S. D. për njohjen e tij si pronar të një shtëpie banimi dhe tokë truall me sip .414 m². Ky vendim ka marrë formë të prerë pasi nuk është ankimuar nga palët ndërgjyqëse.

- Vlerësimi i aftësive profesionale për këtë vendim është jashtë periudhës së përcaktuar nga neni 41/4 i ligjit nr. 84/2016, por subjekti u ftua të japë shpjegime lidhur me këtë çështje gjyqësore.

Në përgjigje subjekti deklaroi se në lidhje me këtë vendim të formës së prerë nuk ka shpjegime, te j atyre që janë arsyetuar në vendim.

2. Në vendimin nr. ***, datë 16.10.2007, subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesë e trupës gjyqësore të Gjykatës së Apelit Vlorë.

- Nuk rezultoi problematikë për këtë çështje gjyqësore që lidhet me subjektin e rivlerësimit.

3. Me vendimin nr. ***, datë 30.1.2018 (çështja penale *****), të Gjykatës së Apelit Vlorë, subjekti i rivlerësimit si kryesuese e trupës gjyqësore ka vendosur “*mospranimin e ankimit të të pandehurit Z. B i deklaruar fajtor për veprën penale ‘vjedhje’, për shkak të heqjes dorë nga ankimi*”.

- Kjo çështje lidhet indirekt me vendimin nr. ***, datë 31.1.2018, cituar më poshtë.

4. Me vendimin nr. *, datë 31.1.2018 (çështja penale ****), të Gjykatës së Apelit Vlorë,** subjekti i rivlerësimit si anëtare e trupës gjykuese (relatore e çështjes) ka vendosur *“deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Z. B për kryerjen e veprës penale ‘prodhim dhe shitje të narkotikëve’, pasi nuk provohet të ketë kryer veprën penale”*.

- Subjekti i rivlerësimit ka marrë 2 vendime në të njëjtën datë për sa i përket të njëjtit të pandehur Z. B (vendimi nr. *** dhe vendimi nr. ***).

- Trupa gjykuese e Gjykatës së Apelit (vendimi nr.***), ku subjekti ka qenë relatore ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe deklarimin e pafajshëm të shtetasit Z. B, duke mos marrë në konsideratë aktekspertimin daktiloskopik nr. ***, datë 24.4.2017, të Institutit të Policisë Shkencore, ku kanë rezultuar se *gjurmët e konstatuarai përkasin të pandehurit Z. B dhe as deklarimin pronarit të mjetit të vjedhur shtetasin M. Z.*

Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit në rezultatet e hetimit lidhur me këtë çështje.

Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, deklaroi: *“Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me këtë çështje nuk kam shpjegime të tjera, përveç atyre të shkruara në arsyetimin e vendimit, i cili rezulton të jetë i parekursuar. Paraqes shkresën nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë”*.

5. Denoncim nr. *prot., datë 5.8.2020, i shtetases M. Sh.**

Me vendimin nr. ***, datë 18.6.2019 (çështja penale *****), të Gjykatës së Apelit Vlorë, subjekti i rivlerësimit si anëtare e trupës gjykuese, duke ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur:

- Lënien e fëmijës R. A., për rritje dhe edukim të paditurit F. A;
- Paditja (nëna e fëmijës) ka të drejtën e takimit.

Ky vendim, i cili në të gjithë përmbajtjen ka datat e vitit 2018, është korrigjuar me vendim nr. ***, datë 24.9.2019, duke vendosur *“ndreqjen e gabimit material të bërë në vendimin nr. ***, në lidhje me vitin e shpalljes së vendimit nga i pasakti 2018 në të saktin 2019”*.

Gjykata, me anë të këtij vendimi, nuk shpjegon bindshëm se kush ishte interesi më i lartë për 2 fëmijët e mitur duke vendosur:

Heqjen e kujdestarisë së 2 fëmijëve nënës së tyre dhe lënies së kujdestarisë vetëm të atit.

Gjykata në këtë vendim nuk ka marrë parasysh:

- provat e paraqitura nga pala paditëse M. Sh;
- babai i fëmijëve ishte pa arsim të detyrueshëm dhe i dënuar me disa vite burgim;
- për babanë e fëmijëve ishte kërkuar dhe marrë urdhër mbrojtje për dhunë në familje;
- ekspertja psikologe E. B., ka arritur në përfundimin se të 2 prindërit shfaqin aftësitë e duhura për prindërim të përshtatshëm.

- Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit në rezultatet e hetimit lidhur me këtë çështje.

Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, deklaroi: *“Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se ankesa ka lidhje me interpretimin dhe vlerësimin e provave nga Gjykata e Apelit, mendoj që veç atyre që janë arsyetuar në vendim, nuk kam shpjegime të tjera. Palët janë dëgjuar, u është dhënë mundësia të debatojnë në lidhje me konkluzionet e akteve të ekspertimit, nga Gjykata e Apelit, provat janë vlerësuar në tërësinë e tyre, në raportin me sjelljen e palëve ndaj fëmijëve të mitur, qëndrimin e fëmijëve të mitur, dhe është arritur në konkluzionin*

se ka qenë në interesin më të lartë të fëmijëve të mitur të qëndrojnë pranë të atit. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm nga Gjykata e Apelit, dhe vlerësoj se pretendimet e saj përbëjnë objekt shqyrtimi gjyqësor nëpërmjet Rekursit”.

6. Subjekti i rivlerësimit, si relatore e çështjes, ka pasur në shqyrtim çështjen gjyqësore civile nr. *****, me palë O. L kundër “*****”. Caktimi i kësaj çështjeje me short për subjektin e rivlerësimit është bërë më 25.10.2016. Subjekti ka filluar procesin gjyqësor dhe njoftimin e palëve datë 12.10.2017. Gjykata, në përfundim, ka kërkuar paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare për këtë çështje në datën 5.11.2019 dhe shpallja e vendimit është bërë datë 6.2.2020. Subjekti ka rezultuar në shkelje dhe tejkalim të afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për shqyrtimin e kësaj çështjeje civile.

Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit në rezultatet e hetimit lidhur me këtë çështje.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi: *“Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me këtë çështje shpjegoj se ka qenë sjellja e palëve që ka shkaktuar zvarritje të procesit gjyqësor. Çështja ka qenë e kthyer për rigjykim nga Gjykata e Lartë, pas rreth gjashtë vjetëve dhe trupi gjykues ka qenë i përbërë nga unë si relatore dhe dy gjyqtarë, të cilët kanë qenë anëtarë të dy kolegjeve të ndryshme, gjë që shkakton vonesa në planifikim, si dhe në caktimin e seancave gjyqësore, pasi gjyqtarët anëtarë duhet të përfundojnë gjykimet me kolegjet e tyre, më pas të vijojnë gjykimet me kolegjet e detyruara.*

Caktimi për gjykim, në vitin 2017 kryhej nga kryetarja e Gjykatës së Apelit, jo nga gjyqtarja relatore, bazuar në nenin 460 të Kodit të Procedurës Civile, pra, kalimi për gjykim i çështjes nuk kryhej nga gjyqtarja relatore.

Palët nuk kanë dhënë ndihmesën e tyre për përfundimin e gjyimit në afatet procedurale të nevojshme, sipas detyrimit të tyre të parashikuar në nenin 15 të Kodit të Procedurës Civile. Fakti që të dyja palët kanë pasur tendencë dhe janë përpjekur të zvarrisin gjykimin vërtetohet me qëndrimin e tyre, të dyja palët, kanë kërkuar përjashtimin e trupit gjykues, të dyja palët kanë kërkuar përjashtimin e tre ekspertëve të ndryshëm të caktuar, nuk kanë lejuar asnjë prej ekspertët për të kryer detyrat e ngarkuara, etj. Pala e paditur vazhdimisht ka paraqitur raport mjekësor në gjykim për të zvarritur gjykimin, fakte këto të pasqyruara në dosje. Në lidhje me afatet e gjyimit, duke qenë të ndërgjegjshëm se kanë qenë vetë shkaktarë për zvarritjen e gjyimit, asnjë prej palëve nuk ka paraqitur padi për shkeljen e afatit të arsyeshëm të gjyimit. Ka rezultuar që ankuesi është gjyq fitues”.

7. Denoncim nr. * prot., datë 11.3.2019, nga OSHEE-ja**

Me vendimin nr. ***, datë 27.12.2018 (nr. regj. **** themeltar), të Gjykatës së Apelit Vlorë, subjekti i rivlerësimit si kryesuese e trupit gjykues (relatore e çështjes), ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 5.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Kjo çështje është zgjidhur shumë shpejt nga Gjykata e Apelit në krahasim me vendimin e përmendur më sipër, çështjen gjyqësore nr. ***** (çështje e regjistruar 2 vjet më parë për gjykim), përfunduar në vitin 2020.

Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Vlorë: ka shqyrtuar një çështje që konsiderohet gjë e gjykuar si dhe; ka shqyrtuar një çështje ku e drejta e padisë është parashkruar.

Pritet që Gjykata e Lartë të shqyrtojë dy çështje, ku objekti i padisë së ngritur në gjykatat e shkallës së parë të jetë i njëjtë “shpërblimi i dëmit pasuror, jopasuror”.

Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit në rezultatet e hetimit lidhur me këtë çështje.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi: *“Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me këtë çështje shpjegoj se ndryshe nga çështja e mëparshme, çështja është kaluar për gjykim nga relatorja, sipas nenit 460/2 të Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar dhe është marrë parasysh që palët kishin paraqitur edhe ankime të veçanta, afati për shqyrtimin e të cilave është një muaj. Janë njoftuar palët për kalimin për gjykim, shkakun e kalimit për gjykim dhe nuk kanë parashtruar kundërshtime.*

Në lidhje me pretendimin se është gjykuar një çështje që mund të jetë gjë e gjykuar, siç është arsyetuar në vendim, nuk ka rezultuar pretendim i bazuar në ligj. Po ashtu, edhe pretendimi i parashkrimit të padisë, është gjetur i pabazuar dhe referencat në prova dhe në ligj gjenden në arsyetimin e vendimit. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm nga Gjykata e Apelit dhe vlerësoj se pretendimet e saj përbëjnë objekt shqyrtimi gjyqësor nëpërmjet rekursit”.

8. Denoncim nr. *prot., datë 15.5.2019, i shtetases L. B.**

Me vendimin nr. ***, datë 19.3.2019 (nr. regj. **** themeltar), të Gjykatës së Apelit Vlorë, subjekti i rivlerësimit si anëtare e trupit gjykues, ka vendosur *lënien në fuqi të vendimit gjyqësor penal nr. ***, datë 5.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.*

Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Vlorë:

- ka shqyrtuar çështjen penale në mungesë të të gjitha palëve (prokuroria, personi nën hetim, trashëgimtarët e viktimës);
- nuk ka marrë në konsideratë mbylljen e menjëhershme të hetimit nga prokurori;
- nuk ka marrë parasysh të metat e mëdha të aktekspertimit, sidomos ajo e shpejtësisë së automjetit që ka shkaktuar aksidentin;
- nuk ka vlerësuar pamjet filmike të vendit të ngjarjes, të cilat janë administruar në dosje me cilësinë e provave materiale;
- nuk vlerësuar pretendimet e palës ankimuese për moskryerjen e një sërë veprimesh procedurale nga prokurori;
- nuk ka vlerësuar të gjitha provat e administruara në dosjen penale, por ka dalë me vendim duke u mbështetur vetëm në një provë të vetme (e cila bie në kundërshtim dhe me provat e tjera të administruara në dosje).

Trupi gjykues, në këtë çështje për dhënien e vendimit, është bazuar vetëm në një provë të vetme, në provën e aktekspertimit. Kjo bie në kundërshtim me arsyetimin e bërë nga subjekti i rivlerësimit në vendimin nr. ***, datë 31.1.2018 (çështja penale nr. *****), të Gjykatës së Apelit Vlorë, ku subjekti, si relatore e çështjes, ka deklaruar: *“... duke zbatuar drejt nenin 4/2 dhe 152 të Kodit të Procedurës Penale dhe qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Gjykatës së Lartë, se fajësia apo pafajësia nuk mund të konkludohet duke u bazuar në një provë të vetme, pavarësisht faktit nëse kjo është një provë shkencore ...”.*

Në pjesën arsyetuese të vendimit nr. ***, datë 19.3.2019, theksohet: *“Në analizë të kërkesës së Prokurorisë nga studimi i të gjitha akteve që ndodhen në dosjen hetimore, gjykata çmon se nga aq sa ka rezultuar nga hetimet paraprake të deritanishme del e nevojshme kryerja e një tërësie veprimesh të tjera hetimore, përpara se vepra penale të klasifikohet sipas paragrafit 1, të nenit 290, të Kodit Penal”.* Pra, rezultoi një nonsens në këtë vendim, pasi nga njëra anë trupi gjykues çmon dhe del e nevojshme kryerja e një sërë veprimesh të tjera hetimore dhe nga ana tjetër shpall vendimin për pushimin e çështjes penale.

Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit në rezultatet e hetimit lidhur me këtë çështje.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi: *“Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me këtë çështje shpjegoj se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë relator, për pasojë nuk ka arsyetuar vendimin. Në lidhje me pasaktësi të mundshme të pjesës arsyetuese janë përgjegjësi e relatorit të çështjes. Në lidhje me konkluzionin e arritur nga provat e shqyrtuara, akti i ekspertimit, i cili është bazuar në të gjitha të dhënat hetimore, në këqyrjen e vendit të ngjarjes, si dhe në deklaratimet e personave që kanë dijeni në lidhje me ngjarjen, nga Gjykata e Apelit është vlerësuar se kërkesa e prokurorit për pushimin e procedimit penal ka qenë e bazuar në prova dhe në ligj. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm nga Gjykata e Apelit dhe vlerësoj se pretendimet e saj përbëjnë objekt shqyrtimi gjyqësor nëpërmjet rekursit”*.

9. Denoncim nr. *prot., datë 18.2.2019, nga BKT-ja**

Me vendimin nr. ***, datë 6.12.2018 (nr. regj. **** themeltar), të Gjykatës së Apelit Vlorë, subjekti i rivlerësimit si kryesuese e trupit gjykues (relatore e çështjes), ka vendosur:

*Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 27.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pranimin e padisë.*

Ky vendim gjyqësor nuk është zbardhur në kohë dhe nuk i është vënë në dispozicion palëve brenda afatit ligjor të përcaktuar nga Kodi i Procedurës Civile.

Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit në rezultatet e hetimit lidhur me këtë çështje.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi: *“Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me sa pretendohet në denoncim, vendimi është zbardhur në kohë, por vendosja në dispozicion e vendimit për palët ka të bëjë me nënshkrimin e vendimit nga të tre gjyqtarët, administrimin e dosjes, dorëzimin e saj në sekretari, veprime që kanë përkuar me periudhën e fundvitit dhe sekretaria gjyqësore është e ngarkuar me procedurën e mbartjes së dosjeve. Gjithashtu, ka përkuar edhe me ndërrimin e sekretareve gjyqësore. Po ashtu, shpjegoj se afati i rekursit të palëve fillon nga vendosja në dispozicion e vendimit të arsyetuar, për pasojë, nuk ka sjellë efekte për palët. Në lidhje me këtë ankesë, paraqes kopje të regjistrimit të dorëzimit të dosjes te sekretarja gjyqësore”*.

10. Denoncim nr. *prot., datë 7.2.2019, i shtetasit M. B.**

Me vendimin nr. ***, datë 7.2.2019 (nr. regj. ***** themeltar), të Gjykatës së Apelit Vlorë, subjekti i rivlerësimit si kryesuese e trupit gjykues (relatore e çështjes), ka vendosur:

*Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 11.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.*

Ky vendim gjyqësor është bazuar në interpretime, bazuar në dëshmitarë dhe prova rrethore dhe jo bazuar në kontratën e lidhur nga palët me vullnet të plotë, ku përcaktohet likuidimi i plotë financiar ndërmjet palëve. Gjykata, në pjesën arsyetuese, pranon që kontrata përbën provë të plotë dhe nuk lejohet prova me dëshmitarë për të provuar të kundërtën e asaj që rezulton nga një “akt zyrtar” dhe vendimi i dhënë rezultoi se është në kundërshtim me këtë arsyetim.

Gjykata, në këtë vendim, është shprehur për shlyerjen e detyrimit kontraktor nga pala blerëse, por jo nga pala shitëse, e cila kishte detyrimin të finalizonte kontratën e shitjes dhe regjistrimin e pronës në emër të blerësit.

Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit në rezultatet e hetimit lidhur me këtë çështje.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi: “Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me këtë denoncim, ankesa ka të bëjë me vlerësimin e provave për të cilat jam shprehur në vendim. Shpjegime të tjera veç atyre të dhëna në arsyetimin e vendimit nuk kam. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm nga Gjykata e Apelit dhe vlerësoj se pretendimet e tij përbëjnë objekt shqyrtimi gjyqësor nëpërmjet rekursit”.

11. Denoncim nr. * prot., datë 31.10.2018, i shtetases R. I.**

Me vendimin nr. ***, datë 27.9.2018 (nr. regj. *** themeltar), të Gjykatës së Apelit Vlorë, subjekti i rivlerësimit si anëtare e trupit gjykues, ka vendosur:

*Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 25.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe rrëzimin e ankimit të ankueses R. I.*

Trupi gjykues ka dhënë një vendim në kundërshtim me faktet dhe rrethanat që përmend në pjesën arsyetuese të vendimit. Objekti i hetimit të prokurorisë për të cilën është regjistruar edhe procedimi penal nr. *** ishte për veprën penale “ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”. Në pjesën arsyetuese të vendimit ndër *indiciet* dhe provat e tjera është provuar fakti i interesimit (pohuar nga gjyqtarja e çështjes), disa herë të kryetarit të gjykatës të gjyqtarja e çështjes (interesim lidhur me ecurinë e çështjes) dhe sidomos në përfundim të shqyrtimit të çështjes dhe dhënies së vendimit (konkludimit në bindjen e gjyqtarës).

Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit në rezultatet e hetimit lidhur me këtë çështje.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi: “Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me këtë denoncim, shkaqet e parashtruara në të, në vlerësimin tim gjejnë përgjigje në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Apelit. Gjatë shqyrtimit të ankimit të ankueses R. I, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se ripyetja e ankueses në lidhje me faktet e pretenduara prej saj, nuk ishte e nevojshme. Ndryshe nga sa ka pretenduar ankuesja është pyetur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda Tiranë, gjithashtu nga përmbajtja e kërkesës ankimore të paraqitur prej saj në gjykatën e shkallës së parë nuk rezultojnë rrethana të ndryshme apo të reja. Pretendimi i denoncueses se zotëronte prova shkresore, të shkruara nga personi nën hetim nuk është vlerësuar si shkak për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal, pasi këto akte nuk janë paraqitur në organin procedues apo në gjykatë, si dhe nuk janë cituar apo dorëzuar në Gjykatën e Apelit, me qëllim që jo vetëm të vërtetohet ekzistenca e tyre, por dhe Gjykata të vlerësonte lidhjen e tyre me çështjen konkrete.

Në lidhje me ekspertizën e zërit, një aktekspertim i tillë është kryer gjatë hetimit paraprak, por denoncuesja nuk ka qenë dakord me konkluzionin e aktekspertimit. Nga verifikimet e kryera nga prokuroria nuk ka qenë e mundur për ekspertët kryerja e verifikimeve të tjera teknike në lidhje me regjistrimet e zërit të ofruara nga denoncuesja.

Në vendimin e pushimit të procedimit penal, nga prokuroria është pranuar fakti në të njëjtat rrethana siç është përshkruar nga ankuesja R. I., ndaj nga Gjykata e Apelit është gjetur i drejtë arsyetimi i prokurorisë se nuk ka qenë e nevojshme kryerja e hetimeve të tjera. Pretendimet e denoncueses R. I. kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm nga Gjykata e Apelit dhe vlerësoj se pretendimet e saj përbëjnë objekt shqyrtimi gjyqësor nëpërmjet Rekursit”.

12. Denoncim nr. * prot., datë 22.9.2018, i shtetasit B. M.**

Me vendimin nr. ***, datë 8.5.2018 (nr. regj. themeltar ***), të Gjykatës së Apelit Vlorë, subjekti i rivlerësimit si kryesuese e trupës gjykuese (relatore e çështjes), ka vendosur:

*Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 18.4.2016, të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Vlorë.*

Nuk rezultoi problematikë për këtë çështje gjyqësore që lidhet me subjektin e rivlerësimit.

13. Me vendimin nr. *** datë 27.6.2008 (nr. regj. themeltar ***), të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtare e vetme, ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit A. K. për veprën penale “kultivim i bimëve narkotike” dhe dënuar me 3 vjet burgim.

Kundër këtij vendimi është bërë ankim dhe Gjykata e Apelit Vorë ka vendosur: *prishjen e vendimit nr. *****, datë 27.6.2008, si dhe pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit.*

Vendimi i dhënë nga subjekti është prishur më pas nga Gjykata e Apelit pas ankimit të të pandehurit.

Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit në rezultatet e hetimit lidhur me këtë çështje.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi: *“Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, në lidhje me këtë vendim, nuk konstatoj të ketë denoncim, por vlerësoj se problematikat e konstatuara nga Komisioni kanë të bëjnë me vlerësimin e provave. Gjykata e Apelit ka marrë prova të reja, të cilat nuk janë kërkuar nga palët gjatë gjykimit në shkallë të parë, ka kryer aktekspertimin psikiatriko-ligjor mbi një shtetas, pa u paraqitur për ekzaminim ky shtetas, dhe ka vlerësuar se dëshmitari mbi të cilin mbështetet akuza, ndaj shtetasit A. K., i cili ka qenë kryetar i fshatit, ka qenë i paaftë mendërisht. Ndërkohë që dëshmitari nuk është dëgjuar personalisht nga Gjykata e Apelit. Pra, vendimi është ndryshuar, bazuar mbi prova të cilat janë kërkuar dhe marrë rishtaz në Gjykatën e Apelit, dhe jo në gjykatën e shkallës së parë. Vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është bazuar në provat që palët kanë paraqitur dhe në kërkesat e tyre, të cilat kanë qenë të ndryshme me ato të paraqitura në Gjykatën e Apelit”.*

14. Në vendimet nr. *** datë 13.11.2007 (nr. regj. themeltar ***) dhe nr. *** datë 11.7.2017, (nr. *** akti), subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesë e trupës gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nuk rezultoi problematikë për këto çështje gjyqësore që lidhet me subjektin e rivlerësimit.

15. Me vendimin nr. *** datë 2.11.2005 (nr. regj. themeltar ***), subjekti i rivlerësimit si anëtare e trupës gjyqësore, ka vendosur deklarami fajtor të të pandehurit G. Sh., gjithsej me 4 vjet dhe 8 muaj burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë pasi nuk është ankimuar nga palët ndërgjyqëse.

Vlerësimi i aftësive profesionale për këtë vendim është jashtë periudhës së përcaktuar nga neni 41/4 i ligjit nr. 84/2016.

16. Denoncim nr. * prot., datë 5.10.2018, i shtetasit Xh. Xh.**

Me vendimin nr. *** datë 2.7.2008 (nr. regj. themeltar ***), të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, subjekti i rivlerësimit si gjyqtare e vetme, ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Xh. Xh dhe dënimin e tij me 6 muaj burg dhe 500,000 lekë gjobë.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit (datën 6.5.2009) dhe Gjykata e Lartë (datë 17.9.2010).

Nuk rezultoi problematikë për këto çështje gjyqësore që lidhen me subjektin e rivlerësimit.

17. Denoncim nr. *prot., datë 5.12.2018, i shtetases I. B.**

Me vendimin nr. ***, datë 29.1.2013 (nr. regj. themeltar ***), të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, subjekti i rivlerësimit si gjyqtare e vetme, ka vendosur:

Pranimin e padisë së paditësit S. B, detyrimin e të paditurit të njohë pronar paditësin.

Gjykata në vendim thekson se e ka zhvilluar gjyqin në mungesë të të paditurve, por sipas këtij vendimi rezulton vetëm një i paditur.

Kjo çështje rezultoi se është zhvilluar ndaj një personi, i cili kishte ndërruar jetë dhe në vendim nuk gjendet asnjë referencë lidhur me gjendjen juridike apo gjendjen civile të palës së paditur;

Gjyqtarja nuk ka administruar të dhënat lidhur me gjendjen civile të palës së paditur apo të trashëgimtarëve.

Procesi gjyqësor është zhvilluar duke njoftuar palën e paditur me anë të shpalljes, ku sipas vërtetimit të datës 18.9.2012, i padituri rezultoi të jetë larguar nga vendbanimi i tij i fundit nga fshati Dh*** që në vitin 1943.

Gjykata i ka hequr të drejtat e pronësisë palës së paditur të përfituar me vendim të komisionit të ndarjes së tokës sipas ligjit nr. 7501/1991 dhe ia ka kaluar të drejtat e pronësisë (pa sqaruar lidhjen e palës paditëse me objektin e gjykimit dhe as konfirmimin nëse pala paditëse ka përfituar apo mund të përfitonte nga ligji për tokën) palës paditëse, duke anashkaluar komisionin e ndarjes së tokës.

Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit në rezultatet e hetimit lidhur me këtë çështje.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi: *“Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me denoncimin e znj. I. B, konstatoj se vendimi ka marrë formë të prerë. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit, rezulton që janë marrë akte nga Zyra e Gjendjes Civile, akte të cilat janë interpretuar në vendimin e gjykatës. Janë zbatuar parashikimet e nenit 133 të Kodi i Procedurës Civile për njoftimin e personave të cilët nuk gjenden në vendbanimin e tyre të fundit, që rezulton sipas akteve të gjendjes civile. Nuk rezulton që shtetasi, palë e paditur të kishte ndërruar jetë, pasi një fakt i tillë nuk ka qenë i pasqyruar në regjistrin e gjendjes civile. Gjithashtu, njoftimi ka qenë i afishuar në Bashkinë Himarë, në rast se ka pasur trashëgimtarë të interesuar nuk kanë pasur pengesë të paraqitshin në gjykim, dhe të ndërhyjnë. Gjykata ka kryer përpjekjet për njoftimin e palës së paditur dhe si nëpunësi postar, ashtu edhe Bashkia Himarë, ku është afishuar njoftimi, nuk kanë bërë me dije Gjykatën për faktet e pretenduara nga ankuesja I. B.*

Ankuesja nuk rezulton të jetë trashëgimtare e palës së paditur, për pasojë, nuk tërheq interes nga gjykimi. Duke qenë se znj. I. B ka pasur shumë gjykime në Gjykatën e Apelit Vlorë, jam në dijeni si shumë kolegë të mi, se znj. I. B është bashkëshortja e vëllait të paditësit, dhe bashkëshorti i saj është gjallë, për pasojë, nuk tërheq të drejta trashëgimore ende. Në gjykim ka qenë palë edhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila nuk ka paraqitur ankim.

Vlerësoj se përveç sa është arsytuar në vendimin e gjykatës, nuk kam për të shtuar. Ankuesja nuk tërheq të drejta trashëgimie, pasi nuk është trashëgimtare e palëve ndërgjyqëse, në të kundërt e drejta e pretenduar prej saj mund të rivendosej me padi trashëgimore”.

18. Denoncim nr. *prot., datë 1.6.2018, i shtetases L. Xh.**

Me vendimin nr. ***, datë 18.12.2012 (nr. regj. themeltar ***), të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, subjekti i rivlerësimit si gjyqtare e vetme, ka vendosur:

*Pranimin e padisë së paditëses Z. B, deklarin absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. ***, datë 19.11.2010, të KVVTP-së Prefekti Vlorë.*

Në përfundim, për sa i përket kësaj çështje, nuk vihet re të ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

19. Në vendimin nr. ***, datë 5.3.2018 (nr. i regjistrimit ***), subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesë e trupës gjykuese të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nuk rezultoi problematikë për këtë çështje gjyqësore që lidhet me subjektin e rivlerësimit.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, arrin në përfundimin se:

A. Për vlerësimin e pasurisë

Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë nuk të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit, për arsye se:

1. Për apartamentin me sip.102.22 m², me vendndodhje lagjja “***”, Vlorë**

- Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë të burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, duke mos u gjendur brenda parashikimeve të gurmës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

- Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2006, duke u gjendur brenda parashikimeve gurmës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

- Subjekti nuk ka deklaruar saktë në pyetësor lidhur me pasuritë e blera nga prindërit e ish-bashkëshortit duke mos përmendur faktin e blerjeve të pasurive të paluajtshme në vlerën 1.000.000 lekë në vitin 2001 dhe në vlerën 500.000 lekë në vitin 2000.

- Subjekti rezultoi në konflikt interesi me shoqërinë “*****” sh.p.k., duke u gjendur në kushtet e gurmës “d”, nenit 33/5. Subjekti në fund të vitit 2003 ka pasur një proces gjyqësor dhe ka pranuar kërkesëpadinë e shoqërisë dhe disa muaj më vonë ka përfituar dhe përdorur pasurinë në pronësi të kësaj shoqërie për vitet 2004 – 2006, pa kundërshpërblim dhe duke e blerë këtë pasuri nën çmimin e tregut.

- Subjekti nuk arriti të provojë pagesën e pretenduar të kryer ndaj shoqërisë “*****”sh.p.k., në vitin 2005 për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme në shumën prej 3.000.000 lekësh, si dhe mosdeklarimin në deklaratën periodike vjetore për vitin 2005.

- Deklarimet për burimet financiare për blerjen e kësaj pasurie sipas deklaratës para fillimit të detyrës të vitit 2003 nuk përputhet me deklaratën *Vetting* të bërë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2017.

2. Për pasurinë automjet tipi “Volkswagen Golf”, me targa ***** , blerë në vlerën 100.000 lekë, subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke u gjendur brenda parashikimeve të gurmës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

3. Për depozitën bankare në “Union Bank”, Vlorë, në vlerën 150.629 lekë, subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke u gjendur brenda parashikimeve të gurmës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

4. Për depozitë bankare në “Union Bank”, Vlorë, në vlerën 200.716 lekë, subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

5. Lidhur me pasuritë e bashkëshortit dhe deklaratimet periodike:

a. automjet tip “Renault”, në vlerën 1.000.000 lekë;

b. automjet tip “Honda”, në vlerën 600.000 lekë;

c. gjendje *cash*: në shumën 2.100.000 lekë, në Bankën e Kursimeve; në shumën 400.000 lekë-Berat- kthim nga vjehri; në shumën 1.000.000 lekë – nga puna në emigracion.

Lidhur me këto pasuri dhe deklaratime, subjekti:

- gjendet në kushtet e deklaratimit të pasaktë të burimit të krijimit në deklaratën e vitit 2003 dhe në krahasim me deklaratën *Vetting*, sipas parashikimeve të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016;

- ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive dhe likuiditeteve, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

6. Për pasurinë automjet tip “BMW”, në vitin 2002, në vlerën 301.214 lekë, subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

7. Për pasurinë automjet tip “Nissan Patrol”, në vlerën 250.000 lekë, subjekti ka pasaktësi në deklaratim, mosdeklarim të çmimit real të blerjes dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

8. Për pasurinë depozitë në “Union Bank”, në shumën 550.000 lekë, subjekti ka pasaktësi në deklaratim dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

9. Analiza financiare për vitet 2003 dhe 2016 – bazuar në të cilën rezultuan balanca negative vjetore për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive.

Për vitin 2003 rezultoi me balancë negative në vlerën 4.898.580 lekë.

Për vitin 2004 rezultoi me balancë negative në vlerën 188.123 lekë.

Për vitin 2005 rezultoi me balancë negative në vlerën 151.840 lekë.

Për vitin 2006 rezultoi me balancë negative në vlerën 2.403.499 lekë.

Për vitin 2010 rezultoi me balancë negative në vlerën 228.881 lekë.

Për vitin 2012 rezultoi me balancë negative në vlerën 15.947 lekë.

Për vitin 2013 rezultoi me balancë negative në vlerën 82.387 lekë.

Për vitin 2015 rezultoi me balancë negative në vlerën 475.469 lekë.

Për vitin 2016 rezultoi me balancë negative në vlerën 611.927 lekë.

Pra, subjekti ka pamundësi financiare për blerjen e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, ndër vite, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 9.056.653 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaratim të pamjaftueshëm për pasuritë e krijuara, si dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke zbritur dhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

10. Duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 1, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, e cila parashikon se: *“Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur”*, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë në pronësi.

Pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”*, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të përmendura në këtë vendim.

Pika 5, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”*, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe në përdorim të tij dhe është përpjekur të fshehë këto pasuri.

Subjekti gjendet në kushtet e germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, subjekti nuk ka kryer deklarim të saktë të pasurive dhe të interesave private, si edhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj, si dhe është përpjekur të fshehë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe bashkëpronësi. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës, i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Për sa më sipër, Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe *cash*) dhe kryerjen e shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si gjyqtare.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit administrativ dhe duke mos iu përgjigjur saktë pyetjeve të Komisionit lidhur me pasuritë. Subjektin e rivlerësimit duhet ta karakterizojë sjellja e denjë, serioze dhe e sinqertë, jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe gjatë zbatimit të detyrimeve të saj gjatë procesit administrativ për rivlerësimin kalimtar.

B. Për vlerësimin e figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. Për vlerësimin e aftësive profesionale

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional për 5 (pesë) çështjet e shortuara, trupi gjykues pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues, në kuptim të gërmës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

Kurse përgjigjet e subjektit lidhur me çështjet e trajtuara nga Komisioni dhe ato të trajtuara nga denoncimet, kanë qenë jo shteruesedhe janë bërë me qëllim shmangien e përgjigjeve lidhur me problematikat e konstatuara. Fakti i moskundërshtimit të tyre dhe dhënia e argumenteve për të kundërshtuar gjetjet e Komisionit nga subjekti, krijoi bindjen e trupit gjykues se këto gjetje qëndrojnë dhe janë të sakta. Trupi gjykues çmon se të gjitha faktet për të cilat subjekti i rivlerësimit është njoftuar nga Komisioni janë konsideruar shkelje të ligjit dhe veprime të njëanshme, për të cilat subjekti i është kaluar edhe barra e provës në kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, këto fakte janë bërë pjesë e arsytimit të konkluzioneve të Komisionit, të pozicionuara në pjesën e denoncimeve dhe gjetjeve nga çështjet gjyqësore, të lidhura me sjellje të caktuara të subjektit dhe vendimmarrjen e saj. Në këtë mënyrë, subjekti i rivlerësimit ka pasur të gjitha mundësitë të mbrohet dhe t'i kundërshtojë duke paraqitur shpjegime të plota dhe prova bindëse.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton nga vlerësimi në tërësi i kriterit të pasurisë dhe vlerësimi profesional lidhur me çështjet e gjykuara dhe problematikat e konstatuara nga Komisioni mbi bazën e të dhënave të mbledhura, denoncimet, dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave sipas nenit 4, paragrafi 2, i ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, ka arritur nivel të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, si dhe ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë duke u gjendur në kushtet e pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të gërmës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 1.2.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI

Kryesuese

Brunilda BEKTESHI

Anëtare

Roland ILIA

Relator

Gledis Hajdini
Sekretare gjyqësore